



Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZGJEDHJET PARLAMENTARE

28 qershor 2009

Misioni i OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve
Raporti Përfundimtar



Varshavë
14 shtator 2009

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE	1
II. HYRJE DHE FALENDERIME	5
III. KONTEKSTI POLITIK	5
IV. KUADRI LIGJOR DHE SISTEMI ZGJEDHOR	6
SISTEMI ZGJEDHOR.....	7
V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE	7
A. ORGANET E ADMINISTRIMIT TË ZGJEDHJEVE.....	7
B. VLERËSIMI I ORGANIZIMIT TË ZGJEDHJEVE.....	8
VI. REGJISTRIMI DHE IDENTIFIKIMI I ZGJEDHËSVE	9
A. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE	10
B. IDENTIFIKIMI I ZGJEDHËSVE	11
VII. REGJISTRIMI KANDIDATËVE	12
VIII. FUSHATA ZGJEDHORE	13
FINANCIMI I FUSHATËS.....	16
IX. MEDIA	16
A. SFONDI I PËRGJITHSHËM MEDIATIK	16
B. RREGULLAT PËR FUSHATËN DHE PASQYRIMI I SAJ NË MEDIA.....	17
C. MONITORIMI I MEDIAS NGA MISIONI VËZHGUES I OSBE/ODIHR-IT	18
X. PJESËMARRJA E GRAVE	20
XI. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE	21
XII. VËZHGUESIT VENDAS	21
XIII. ANKESAT DHE KËRKESËPADITË GJATË PERIUdhËS PARAZGJEDHORE	22
XIV. VOTIMI DHE NUMËRIMI	23
A. DITA E ZGJEDHJEVE	23
B. NUMËRIMI I VOTAVE	24
XV. Mbledhja dhe shpallja e rezultateve nga KQZ-JA	27
XVI. ANKESAT NË LIDHJE ME DITËN E ZGJEDHJEVE	28
A. GJYKIMI I ANKESAVE PASZGJEDHORE NGA KQZ-JA	28
B. GJYKIMI I ANKESAVE PASZGJEDHORE NGA KOLEGJI ZGJEDHOR	30
XVII. REKOMANDIME	31
A. PARTITË POLITIKE	31
B. KUADRI LIGJOR	31
C. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE.....	32
D. REGJISTRIMI DHE IDENTIFIKIMI I ZGJEDHËSVE	32
E. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE	32
F. FUSHATA ZGJEDHORE.....	33
G. MEDIA	33
H. VOTIMI, NUMËRIMI, PËRMBLEDHJA DHE SHPALLJA E REZULTATEVE	33
I. ANKESAT DHE KËRKESËPADITË.....	34
J. PJESËMARRJA E GRAVE	34
K. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE	35
SHTOJCË: REZULTATET E ZGJEDHJEVE	36
RRETH OSBE/ODIHR-IT	37

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZGJEDHJET PARLAMENTARE
28 qershor 2009

Misioni i OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve
Raporti Përfundimtar

14 shtator 2009

I. PËRMBLEDHJE

Pas ftesës së Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë për të vëzhguar zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit 2009, Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) dërgoi në Shqipëri Misionin e Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ). MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vlerësoi përputhjen e procesit zgjedhor me angazhimet ndaj OSBE-së, me standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin vendas. Lidhur me vëzhgimin gjatë ditës së zgjedhjeve, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it bashkëpunoi me Asamblenë Parlamentare të OSBE-së, Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe Asamblesë Parlamentare të NATO-s me qëllim formimin e një Misioni Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MNVZ).

Zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit 2009 shënuan një progres të prekshëm për sa i përket regjistrimit të votuesve dhe procesit të identifikimit, kuadrit ligjor të miratuar në mënyrë konsensuale nga dy partitë kryesore në vend, për sa i përket votimit, numërimit dhe gjykimit të konflikteve zgjedhore. Këto përmirësime të konsiderueshme u zbehën nga politizimi i aspekteve teknike të procesit lidhur me numërimin e votave dhe hartimin e tabelave të rezultateve, gjë që përkohësisht bllokoi procesin e numërimit në disa zona, si edhe nga shkeljet e vëna re gjatë fushatës zgjedhore. Këto veprime të partive politike lëkundën besimin e publikut në procesin zgjedhor.¹

Edhe pse përmbushën shumicën e angazhimeve ndaj OSBE-së, këto zgjedhje nuk realizuan plotësisht potencialin e Shqipërisë për t'iu përmbajtur standardeve më të larta për zgjedhje demokratike. Zhvillimi i zgjedhjeve demokratike varet gjithashtu, në një masë të madhe, nga angazhimi i të gjitha partive politike shqiptare për të respektuar ligjin dhe qëllimin e tij në detajin më të vogël, si dhe për t'iu përmbushur detyrat e tyre zgjedhore në mënyrë të përgjegjshme me synim ruajtjen e integritetit të procesit.

Zgjedhjet u zhvilluan sipas një Kodi të ri Zgjedhor të miratuar në fund të vitit 2008. Kodi i ri pasqyrore disa nga rekomandimet e dhëna më parë nga OSBE/ODIHR-i dhe solli përmirësime të rëndësishme. Për shembull, sistemi i përfaqësimit rajonal proporcional zëvendësoi sistemin e mëparshëm të debatueshëm zgjedhor dhe regjistri kombëtar i kompjuterizuar i popullatës u krijua si burim për listat e zgjedhësve. Përgjithësisht, kuadri ligjor përbën një themel të kompletuar teknik për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike. Megjithatë, një sërë dispozitash duhet të rishikohen në mënyrë që kuadri ligjor të sillet plotësisht në përputhje me angazhimet ndaj OSBE-së dhe standardeve të tjera ndërkombëtare.

Pavarësisht kufizimeve të mëdha kohore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) i përgatiti dhe i administroi zgjedhjet me profesionalizëm, si dhe mori një sërë hapash për rritjen e

¹ MNVZ-ja publikoi një Deklaratë të Konstatimeve dhe Konkluzioneve Paraprake më 29 qershor 2009. Kjo deklaratë dhe të gjitha raportet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it mbi zgjedhjet në Shqipëri mund të gjenden në www.osce.org/odihr-elections/14208.html.

transparencës së procesit. Mbledhjet e KQZ-së ishin përgjithësisht transparente dhe u zhvilluan me profesionalizëm. Megjithatë, shpesh KQZ-ja pati ndarje përgjatë linjave politike mazhoritare-minoritare, veçanërisht rreth çështjeve më të debatueshme. Si edhe në zgjedhjet e mëparshme, u vunë re probleme gjatë caktimit të komisioneve zgjedhore të nivelit të ulët, ku partitë përdorën të drejtën e tyre për të zëvendësuar anëtarët e komisioneve në mënyrë të paarsyeshme, gjë që ndikoi në efikasitetin e administrimit të zgjedhjeve dhe pati pasoja negative mbi integritetin e procesit. Emërimi i Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV) përfundoi tepër vonë, duke penguar kështu trajnimin e anëtarëve të KQV-ve.

Një zhvillim i rëndësishëm pozitiv kishte të bënte me listën e zgjedhësve, e cila për herë të parë u hartua mbi bazën e Regjistrimit elektronik Kombëtar të Gjendjes Civile, dhe jo nga dokumentacioni i mbajtur në nivel vendor. Të drejtën për të votuar e patën 3,084,946 shtetas. Raportet e bëra nga vëzhguesit e MNVZ-së ditën e zgjedhjeve tregojnë se cilësia e listave të zgjedhësve është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme që nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2005.

Një projekt tjetër i madh i Qeverisë ishte lëshimi i kartave të reja dhe të sigurta të identitetit për të gjithë shtetasit. Prioritet ishte pajisja e rreth 730,000 zgjedhësve me karta identiteti. Këta zgjedhës kishin të drejtën e votës, por nuk dispononin pasaportë të vlefshme, të vetmin dokument tjetër identifikimi për votuesit. Fillimi me vonesë i programit në janar 2009 ngriti shqetësimin se një numër përcaktues votuesish mund të mbeteshin pa mjet të vlefshëm identifikimi dhe, për rrjedhojë, do ta kishin të pamundur të votonin. Duke pasur parasysh kufizimet e ndryshme, fushata e shpërndarjes së kartave të identitetit ishte përgjithësisht e suksesshme dhe vendosi bazën për një sistem solid të identifikimit të zgjedhësve. Përpara ditës së zgjedhjeve, nga mbi 1.4 milion aplikime për karta identiteti, nuk u përpunuan vetëm 3,321 aplikime. Rreth 257,000 shtetas që nuk kishin pasaportë, nuk aplikuan për kartën e identitetit.

Programi i kartave të identitetit ishte një nga çështjet më të debatueshme të zgjedhjeve. Partitë opozitare vunë në pikëpyetje administrimin e këtij procesi dhe ngritën pretendime për manipulim me motive politike. Edhe pse MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it verifikoi disa raste të përfshirjes së padrejtë të aktivistëve të Partisë Demokratike (PD) në pushtet në proces, shumica e problemeve erdhën si pasojë e deficiteve në menaxhim dhe kapacitete, si dhe e mungesave në infrastrukturë. Politikisht, mosmarrëveshja më e madhe lidhur me procesin e kartave të identitetit lindi pasi Qeveria nuk dha shifra të sakta mbi ecurinë e procesit të aplikimeve të shtetasve pa pasaporta.

Megjithëse zgjedhjet u zhvilluan në një mjedis politik shumë të polarizuar, fushata në më të shumtën e saj ishte e qetë dhe pati raportime vetëm për pak incidente të dhunshme. Të 34 partitë që i kontestojnë këto zgjedhje, patën mundësi të bënin fushatë të lirë në të gjithë vendin. Në disa raste fushata zgjedhore u dëmtua nga përdorimi i një gjuhe tejet të ashpër. Dispozitat mbi vendosjen e posterave dhe të banderolave nuk u vunë në zbatim në mënyrë të njëtrajtshme. Kjo gjë, si dhe vendosja e stendave dhe çadrave zgjedhore, bënë që të lindnin polemika në disa rajone të vendit.

Në MVZ-në e OSBE/ODIHR-it mbërritën një sërë aludimesh trysnie, disa prej të cilave u verifikuan, si p.sh mbi presionet për të marrë pjesë në aktivitetet e fushatës së PD-së ose për t'u distancuar nga veprimtaritë e opozitës, shpesh të shoqëruara edhe me kërcënime për largim nga puna. Në veçanti, nga këto presione u prekën punonjësit e sektorit publik dhe studentët e universiteteve. Veprime të tilla shkelin paragrafin numër 7.7 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së. Qeveria vazhdimisht përdori aktivitetet zyrtare, përfshirë inaugurimet e projekteve të infrastrukturës, për të bërë fushatë zgjedhore. Edhe Kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe udhëheqësi i Partisë Socialiste (PS), Edi Rama, përdori veprimtaritë zyrtare për fushatë për PS-në, edhe pse këtë e bëri shumë më rrallë. U vërtetuan aludime për keqpërdorim të burimeve

administrative nga ana e PD-së për qëllime fushate. Veprime të tilla e bënë të paqartë dallimin mes veprimtarive shtetërore dhe atyre partiake, në kundërshtim me paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së.

Shqipëria ka një numër të lartë të mediave transmetuese dhe atyre të shkruara, të cilat konkurrojnë mes tyre për të ardhurat e kufizuara nga reklamat dhe përgjithësisht varen nga bizneset që i subvencionojnë. Kjo, së bashku me ndërhyrjet në politikën editoriale nga politikanët dhe interesat e biznesit, ka ndikim mbi pavarësinë e mediave. Reforma e transmetuesit publik, i cili varet nga financimi shtetëror, ka mbetur në vend.

Kodi Zgjedhor përmban rregulla të hollësishme për pasqyrimin e fushatës zgjedhore në edicionet e lajmeve dhe programet informative si të transmetuesve publikë, ashtu edhe të atyre privatë. Partitë më të vogla nuk përfituan pasqyrimin që u takonte në media sipas Kodit Zgjedhor. Bordi i Monitorimit të Mediave (BMM) të KQZ-së nuk ishte në gjendje të përmbushte të tërë përgjegjësitë e tij për të përcaktuar nëse transmetuesit shlyen detyrimin e tyre ligjor për të pasur “pluralizëm informacioni”.

Monitorimi i mediave nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it tregoi që përpara fillimit të periudhës zyrtare të fushatës, transmetuesit e monitoruar mundësuan pasqyrim të njëanshëm dhe të pjesshëm të dy partive politike kryesore (PD-së dhe PS-së). Gjatë periudhës 30 ditore zyrtare të fushatës, pasqyrimi sasior mbi partitë kryesore ishte më i balancuar. Gjithsesi, të gjithë transmetuesit e monitoruar shfaqën njëanshmëri qoftë kundrejt PD-së apo PS-së, gjë që u reflektua në tonin e pasqyrimin. Sipas informacionit të marrë nga gazetarët, pasqyrimi i fushatës u reduktua më së shumti në kronika me koment të prodhuar dhe siguruar nga vetë partitë politike.

Dispozitat e reja të Kodit Zgjedhor vendosën kushtin gjinor të përfaqësimit 30% si në listat e kandidatëve, ashtu edhe për anëtarët e KZAZ-ve të emëruar nga dy partitë kryesore. Shumë prej listave të kandidatëve u desh t'u ktheheshin partive paraqitëse, për shkak se nuk ishte përmbushur kushti gjinor. Formulimi i kushtit gjinor për listat e kandidatëve i lejoi partitë të anashkalonin objektivin për rritjen e pjesëmarrjes së grave. Megjithatë, krahasuar me zgjedhjet e vitit 2005, kushti i ri çoi në rritjen e deputeteve gra të zgjedhura në Parlament.

Në zgjedhje morën pjesë edhe disa parti që përfaqësojnë minoritetet. Kështu, u zgjodh një anëtar i minoritetit grek nga Partia për Bashkimin e të Drejtave të Njeriut, siç u zgjodhën përfaqësues grekë nga listat e PD-së dhe PS-së. Në pah dolën edhe disa çështje, lidhur me zgjedhjet, të ngritura nga komuniteti rom, më së shumti në lidhje me procesin e shpërndarjes së kartave të identitetit. Në MVZ-në e OSBE/ODIHR-it kanë ardhur gjithashtu aludime të shumta lidhur me blerjen e votave në komunitetet rom, disa prej të cilave u vërtetuan.

Duke theksuar transparencën e këtyre zgjedhjeve, u akredituan mbi 6,000 vëzhgues jopartiakë vendas nga 16 OJQ shqiptare, përfshirë një koalicion prej gjashtë OJQ-sh të cilat akredituan mbi 2,300 vëzhgues. Dy OJQ shqiptare zhvilluan një ushtrim paralel mbi hartimin e tabelave të rezultateve të votimit.

Apelimet gjatë periudhës parazgjedhore u shqyrtuan nga KQZ-ja dhe Kolegji Zgjedhor në mënyrë profesionale dhe të drejtë, duke u dhënë atyre zgjidhje efektive.

Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht e qetë. Gjatë hapjes së qendrave të votimit, u vunë re probleme për sa i përket regjistrimit të numrave serialë të vulave të kutive të votimit dhe mungesës së materialeve zgjedhore. Vëzhguesit e vlerësuan votimin pozitivisht në 92 % të qendrave të votimit të vizituara por vunë re një numër shkeljesh procedurale. Në veçanti,

procedura e markimit me bojë nuk ndiqej gjithmonë, duke zhvlerësuar në këtë mënyrë një element sigurie të rëndësishëm kundër votimit të shumëfishtë. Probleme të tjera serioze përfshijnë përhapjen e gjerë të votimit familjar, votimi në emër të personave të tjerë, raste të tëra ku në listat e zgjedhësve kishte firma në dukje të ngjashme, i njëjti person që “ndihmon” më shumë se një votues, përpjekje për të influencuar votuesit, dhe presion mbi votuesit apo mbi zyrtarët zgjedhorë. Mbyllja e qendrave të votimit u vlerësua përgjithësisht me notë pozitive, me disa probleme procedurale.

Numërimi i kutive u vlerësua si i keq ose shumë i keq në 22 nga 66 Vendet e Numërimit të Votave (VNV). Vëzhguesit e MNVZ-së vunë re mangësi procedurale të cilat dukej se ishin pjesërisht pasojë e trajnimit dhe udhëzimeve të pamjaftueshme. Sistemi i ri i monitorimit elektronik, përmes së cilit çdo fletë votimi vendosej nën një videokamerë dhe u tregohej vëzhguesve në ekrane të mëdha disa metra më larg nga tavolinat e numërimit, duket se e ka arritur vetëm pjesërisht synimin e rritjes së besimit në procesin zgjedhor dhe të transparencës së tij. Shpesh nuk ishte e mundur të shihej se cilën parti kishin zgjedhur votuesit në fletën e votimit, as në cilin grumbull vendosej ajo. Ndërsa vazhdonte numërimi, partitë politike filluan të ndërhyjnë në mënyrë më aktive, veçanërisht kur rezultatet ishin ose dukej se do të ishin të afërta mes partive. Për rrjedhojë, procesi ndaloi në disa VNV dhe KZAZ, të cilat patën probleme për të kontrolluar procesin. Në një numër VNV-sh, kutitë e votimit nuk u numëruan, ose rezultatet nuk u pasqyruan në Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve (TPR) të Zonës së Administrimit Zgjedhor. KQZ-ja shpesh nuk ndërhyri me vendosmërinë e duhur, kur u vunë re problemet apo kur u raportuan ato në VNV-të përkatëse.

Pavarësisht nga disa ngjashmëri me zgjedhjet e mëparshme, pati një ecuri të dukshme në administrimin e procesit nga KQZ-ja, më së shumti në mënyrën e rregullt të marrjes së materialeve zgjedhore nga VNV-të, në transmetimin elektronik të rezultateve nga VNV-të në KQZ, si dhe në shpalljen e rezultateve paraprake. Nuk pati asnjë provë të numërimit të parregullt ose të manipulimit të rezultateve, dhe, përveç bllokimit të numërimit në disa prej VNV-ve, nuk pati as ndonjë parregullsi të madhe në VNV.

KQZ-ja hartoi tabelat e rezultateve për të 12 zonat zgjedhore, bazuar mbi tabelat e rezultateve dorëzuar nga KZAZ-të, dhe i miratoi të gjitha me shumicën e thjeshtë prej katër votash nga anëtarët që përfaqësonin partitë në pushtet. Rezultatet e përpiluara nga KQZ-ja nuk përfshinë rezultatet e 33 qendrave të votimit, pesë prej të cilave nuk u hapën fare gjatë ditës së votimit, ndërsa 28 ose nuk ishin numëruar, ose rezultatet e tyre nuk ishin përfshirë në tabelat e rezultateve të KZAZ-ve përkatëse. Rezultatet nga këto 28 qendra votimi u përfshinë gjatë procesit të apelimit paszgjedhor në KQZ.

Numri i apeleve që u dorëzuan në KQZ (34 apelime) pas zgjedhjeve, ishte shumë më i ulët në krahasim me zgjedhjet e mëparshme. Një arsye për këtë mund të jetë reduktimi i zonave zgjedhore nga 100 në 12. Gjatë procesit të apelimit paszgjedhor, ndasitë politike brenda KQZ-së u bënë edhe më shumë të dukshme se në periudhën parazgjedhore. Gjithsesi, ndryshimet në tabelat e rezultateve për zonat zgjedhore të bëra pas procesit të apelimit, u kaluan me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm të KQZ-së. Vendimet mbi shpërndarjen e mandateve për të dymbëdhjetë zonat dhe deklaratat e rezultateve përfundimtare u kaluan gjithashtu me unanimitet.

Pesë vendime të KQZ-së mbi apelimet paszgjedhore u kundërshtuan në Kolegjin Zgjedhor. Në total, u depozituan 12 apelime kundër këtyre vendimeve, prej të cilave Kolegji Zgjedhor u shpreh vetëm në favor të njërit. Seancat në Kolegjin Zgjedhor u zhvilluan në mënyrë profesionale dhe vendimmarrja u duk se ishte e shpejtë.

II. HYRJE DHE FALENDERIME

Pas ftesës së Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë për të vëzhguar zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit 2009, OSBE/ODIHR-i krijoi më 8 maj 2009 Misionin për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) në Republikën e Shqipërisë. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it drejtohej nga Ambasadorja Audrey Glover (Odri Glavë) dhe përbëhej nga 40 ekspertë dhe vëzhgues afatgjatë nga 20 shtete pjesëmarrëse në OSBE, të cilët u vendosën si në Tiranë, ashtu edhe në 11 qendrat rajonale. Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së sollën gjithashtu rreth 300 vëzhgues afatshkurtër për të vëzhguar gjatë ditës së zgjedhjeve.

Për të vëzhguar gjatë ditës së zgjedhjeve, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it iu bashkua delegacioneve të vëzhguesve të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së (AP e OSBE-së), Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE) dhe Asamblesë Parlamentare të NATO-s (AP e NATO-s) duke formuar kështu një Mision Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MNVZ). Z. Wolfgang Grossruck, që drejtonte delegacionin e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, u caktua nga Kryetari i Radhës së OSBE-së si Koordinator Special për të udhëhequr misionin e vëzhguesve afatshkurtër të OSBE-së. Znj. Korin Jonker drejtoi delegacionin e APKE-së, ndërsa Z. Bruce George (Brus Xhorxh) drejtoi delegacionin AP-së së NATO-s. Gjatë ditës së zgjedhjeve, MNVZ shpërndau në terren 395 vëzhgues nga 38 shtete pjesëmarrëse të OSBE-së, të cilët vëzhguan hapjen e 121 qendrave të votimit, votimin në rreth 1,400 nga 4,753 qendrat e votimit në Shqipëri, dhe mbylljen e 112 qendrave të votimit. MNVZ-ja gjithashtu vëzhgoi numërimin e votave në të 66 Vendet e Numërimit të Votave (VNV).

Misioni i OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve i është mirënjohës Ministrisë së Punëve të Jashtme, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, autoriteteve të tjera, partive politike dhe shoqërisë civile të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin e tyre. Gjithashtu, Misioni dëshiron të shprehë vlerësimin e tij për Përfaqësinë e OSBE-së në Shqipëri, për misionet diplomatike të Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së, si dhe për organizatat ndërkombëtare të pranishme në Shqipëri për mbështetjen e tyre.

III. KONTEKSTI POLITIK

Shqipëria është një republikë parlamentare, pushteti legjislativ i së cilës qëndron me Kuvendin, ndërsa pushteti ekzekutiv me qeverinë e udhëhequr nga Kryeministri. Zgjedhjet e 28 qershorit ishin të parat që u zhvilluan nën një sistemi zgjedhor proporcional rajonal, i cili erdhi si rezultat i reformave të miratuara në një atmosferë konsensuale ndërmjet dy partive kryesore politike, Partisë Demokratike (PD) dhe Partisë Socialiste (PS). Sipas sistemit të mëparshëm zgjedhor, 100 deputetë zgjidheshin nga zonat njëmërore dhe 40 mandatet e tjera plotësoheshin nga listat kombëtare shumëmërore, me qëllim që të arrihej një qasje proporcionale. Vënia në zbatim e këtij sistemi, i njohur si fenomeni “Dushk”, lejonte partitë e mëdha që të maksimizonin përfitimin e tyre duke zhvendosur votat e proporcionalit tek aleatët e tyre më të vegjël pa qenë nevoja që të humbitnin vendet e fituara në zonat njëmërore.²

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2005 u fituan nga një koalicion i udhëhequr nga PD-ja. Si këto, ashtu edhe zgjedhjet vendore të vitit 2007, u vlerësuan se kishin “përmbushur vetëm pjesërisht angazhimet e OSBE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës.”

² Shiko Raportin Përfundimtar të OSBE/ODIHR-it mbi zgjedhjet parlamentare të vitit 2005 në Republikën e Shqipërisë në www.osce.org/odihr-elections/14208.html.

Shumë nga partitë e vogla shprehën pakënaqësi me sistemin e ri zgjedhor, i cili, sipas tyre, favorizonte dy partitë e mëdha. Në veçanti, kundërshtimi i tyre ishte se, nën sistemin e ri, dy partitë më të mëdha dominonin administratën zgjedhore. Ata gjithashtu kundërshtuan sepse, sipas sistemit rajonal proporcional, ku disa prej zonave zgjedhore prodhojnë një numër të vogël vendesh, pragu që përfaqësuesit e partive të vogla duhej të kapnin për t'u zgjedhur do të ishte i paarritshëm.

IV. KUADRI LIGJOR DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Zgjedhjet parlamentare të 2009-ës u zhvilluan sipas një kuadri ligjor që përfshinte dispozita nga Kushtetuta e Shqipërisë (ndryshuar së fundmi në prill 2008) dhe nga Kodi i ri Zgjedhor i miratuar në dhjetor 2008.³ Ndryshimet kushtetuese dhe Kodi i ri ishin rezultat i reformës zgjedhore të filluar pas zgjedhjeve vendore të vitit 2007. Në to u pasqyruan disa nga rekomandimet e dhëna më parë nga OSBE/ODIHR-i. Këto ndryshime sollën përmirësime të ndjeshme, veçanërisht në sistemin zgjedhor dhe regjistrimin e votuesve, por gjithashtu edhe në numërimin e votave dhe procesin e ankimit dhe apelit.⁴ Përgjithësisht, legjislativi përbën një themel të plotë teknik për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike. Gjithsesi, këto zgjedhje treguan edhe një herë që një zhvillim i tillë varet nga angazhimi i partive politike për të respektuar dhe për t'iu përmbajtur jo vetëm çdo aspekti të ligjit, por edhe qëllimit të ligjës, gjë që mungoi në disa raste.

Pavarësisht këtyre aspekteve pozitive, Kodi Zgjedhor vazhdon të ketë dispozita të paqarta dhe të mjegullta. Në mënyrë që Kodi të jetë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare dhe angazhimet e OSBE-së, duhet që të rikonsiderohen një sërë dispozitash, në veçanti Neni 67.3, që i lejon krerët e partive politike të kandidojnë në atë zonë sa dëshirojnë të kandidojnë. Kjo mund të bjerë ndesh me parimet e barazisë⁵ dhe ato të mosdiskriminimit. Neni 146.3, që u jep dy partive më të mëdha të mazhorancës parlamentare dhe opozitës të drejtën që secila të largojë një nga gjyqtarët e përzgjedhur me short për shqyrtimin e apeliave zgjedhore, vë në pikëpyetje përputhshmërinë me parimin e pavarësisë së gjyqësorit.⁶

Dispozitat që rregullojnë pranimin e materialeve zgjedhore dhe procedurat e numërimit në VNV janë përmirësuar, me qëllim minimizimin e mundësive për prishjen apo bllokimin e procesit të numërimit. Pavarësisht dispozitave shumë të hollësishme, Kodi Zgjedhor nuk përcakton qartë se si duhet të merren KZAZ-të me parregullsitë që zbulohen pas hapjes së kutive të votimit dhe që mund të demonstrojnë shkelje të ligjit. Në disa raste gjatë numërimit të votave ky vakum çoi në interpretime arbitrare dhe *contra legem*.

Kodi kufizon mundësinë për përsëritjen e zgjedhjeve në një zonë pas zhvlerësimit të zgjedhjeve në një ose më shumë qendra votimi. KQZ-ja mund të urdhërojë përsëritjen e zgjedhjeve nëse

³ Ligjet e tjera që aplikohen gjatë zhvillimit të zgjedhjeve përfshijnë, *inter alia*, Ligjin për Partitë Politike, Ligjin për Demonstratat, Ligjin për Policinë e Shtetit, Kodin Penal, si dhe Vendime dhe Udhëzime të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe të Këshillit të Ministrave.

⁴ Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës dhe OSBE/ODIHR kanë dhënë një Opinion të Përbashkët mbi Kodin Zgjedhor, i disponueshëm në www.osce.org/documents/odihr/2009/03/36881_en.pdf.

⁵ Neni 26 i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike; Neni 7 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut; Protokollin 12 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore; Paragrafi 7.6 i Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së.

⁶ Parimet Bazë të OKB-së mbi Pavarësinë e Gjyqësorit; Paragrafi 5.12 i Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së; Paragrafët 19.1 dhe 19.2 të Dokumentit të Moskës së OSBE-së. Shiko gjithashtu Opinionin e Përbashkët mbi Kodin Zgjedhor (shënimi 4 *sipër*), paragrafi 84.

pavlefshmëria e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi ndikon në shpërndarjen e mandateve në atë zonë.⁷

SISTEMI ZGJEDHOR

Parlamenti i Shqipërisë është organ me një dhomë i përbërë nga 140 deputetë, të zgjedhur për një periudhë katërvjeçare. Ndryshimet kushtetuese shfuqizuan sistemin e mëparshëm të debatueshëm zgjedhor dhe vendosën një sistem të përfaqësimit rajonal proporcional. Deputetët e Kuvendit tani zgjidhen me lista të mbyllura në 12 zona që u korrespondojnë rajoneve administrative të Shqipërisë. Zonat janë me madhësi të ndryshme, me numër mandatesh që varion nga katër në Kukës në 32 në Tiranë, bazuar në numrin e shtetasve të regjistruar në secilën nga zonat. Për të pasur të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e mandateve në një zonë, Kodi Zgjedhor përcakton një prag prej tre përqind të votave në favor të partive politike dhe pesë përqind për koalicionet në nivel zone. Kandidatët e pavarur duhet të kalojnë pragun natyror (pra, numrin e votave të vlefshme pjesëtuar për numrin e mandateve) në një zonë, në mënyrë që të fitojnë një mandat.

V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

A. ORGANET E ADMINISTRIMIT TË ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit u administruan nga një administratë zgjedhore me tre nivele, e përbërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), 66 Komisione Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ), dhe 4,753 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV). Numërimi i votave u zhvillua në 66 VNV, një për çdo Zonë Administrimi Zgjedhor (ZAZ). Çdo VNV kishte nga pesë deri në dhjetë Grupe Numërimi Votash (GNV) që punonin nën autoritetin e KZAZ-ve përkatëse.

KQZ-ja është një organ i përhershëm, shtatë anëtarët e të cilit zgjidhen nga Parlamenti për një periudhë katërvjeçare me mundësi rizgjedhjeje. Kryetari dhe dy anëtarë u emëruan nga PD-ja, partia më e madhe e mazhorancës parlamentare, dhe një anëtar nga Partia Republikane (PR), pjesë e mazhorancës parlamentare. Zëvendës Kryetari dhe një anëtar u emëruan nga PS-ja, partia kryesore opozitare, dhe një anëtar nga Partia Social Demokrate (PSD), edhe kjo në opozitë. Po ashtu, partitë politike parlamentare, si edhe partitë që konkurrojnë në zgjedhje kanë të drejtën të emërojnë përfaqësues në KQZ. Këto përfaqësues mund të marrin pjesë në diskutime dhe të japin propozime, por nuk kanë të drejtën e votës.

Gjatë periudhës zgjedhore, KQZ-së i kërkohet që të mblidhet çdo ditë në seanca të hapura. Vendimet merren me votën e shumicës, d.m.th katër nga shtatë. Gjithsesi, nevojitet një mazhorancë prej pesë votash për të marrë vendime në lidhje me: shpërndarjen e mandateve në secilën prej zonave zgjedhore; pranimin e ankesave lidhur me Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të një zone zgjedhore; zhvlerësimin e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi; zhvlerësimin dhe përsëritjen e zgjedhjeve në një zonë të tërë zgjedhore ose edhe në të gjithë vendin; miratimin e udhëzimeve; miratimin e strukturës organizative të KQZ-së dhe rregullin e procedurave; propozimet për largimin e anëtarëve të KQZ-së; përcaktimin e numrit të mandateve për secilën zonë zgjedhore dhe përvijimin e ZAZ-ve.

⁷ Sipas Nenit 161.2 të Kodit Zgjedhor, një ndikim i tillë ekziston nëse numri i votuesve, të cilët, ose kanë votuar ose mund të kenë votuar në qendrat e votimit ku votimi u deklarua i pavlefshëm, është ose i barabartë ose më i madh se numri i votuesve që kërkohet për shpërndarjen e një mandati në zonën përkatëse (dhe jo si në rastet kur numri i është aq i madh, sa mandati mund të kalohet nga njëri kandidat tek tjetri).

KZAZ-të e caktuara nga KQZ-ja përbëhen nga shtatë anëtarë, përfshirë kryetarin dhe zëvendës kryetarin, dhe ndihmohen nga një sekretar/e. Formula e emërimit të anëtarëve të KZAZ-ve reflekton atë të KQZ-së. Në gjysmën e KZAZ-ve, kryetarët u emëruan nga PD-ja, dhe në gjysmën tjetër, nga PS-ja. Zëvendës kryetari dhe sekretari i përkasin partisë kryesore politike, që nuk mban kryesimin e KZAZ-së.

Qendrat e votimit administrohen nga KQV-të, që caktohen nga KZAZ-të me të njëjtën formulë si edhe për KZAZ-të. Çdo subjekt zgjedhor (parti politike, koalicion, ose kandidat i propozuar nga një grup zgjedhësish) ka të drejtën të caktojë vëzhgues në KZAZ, KQV dhe në çdo tavolinë numërimi në VNV. Nëse partitë formojnë një koalicion, e drejta për caktimin e vëzhguesve i takon koalicionit dhe jo partive. Kandidatët lejohen që të jenë të pranishëm gjatë numërimit të votave.

B. VLERËSIMI I ORGANIZIMIT TË ZGJEDHJEVE

Pavarësisht kufizimeve kohore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i përgatiti dhe i administroi zgjedhjet me profesionalizëm. Personeli i drejtorive të ndryshme të KQZ-së i kreu detyrat e tij përgjithësisht në mënyrë profesionale dhe me paanshmëri. KQZ-ja gjithashtu caktoi edhe 12 Inspektorë Rajonalë dhe 12 Ndhmës Inspektorë, për të mundësuar një koordinim më të mirë mes KQZ-së dhe KZAZ-së. Në përpjekje për të rritur transparencën, KQZ-ja e përditësonte rregullisht faqen e saj të internetit, dha transmetime direkte të seancave të KQZ-së në internet, vendosi programe të reja për transmetimin e rezultateve të numërimit të votave nga VNV-të në KQZ dhe për shpalljen e rezultateve paraprake, si edhe monitorimin me video dhe regjistrim të numërimit të votave në VNV-të.

Si edhe në zgjedhjet e mëparshme, u vunë re probleme gjatë emërimit të anëtarëve të komisioneve zgjedhore të niveleve të ulta. Ndërkohë që KZAZ-të u krijuan brenda afateve ligjore, shumë nga partitë i dorëzuan kandidaturat e tyre me vonesë. PS-ja fillimisht nuk iu përmbajt kërkesës ligjore që të paktën 30 për qind të emërimeve të saj në shkallë vendi të ishin të së njëjtës gjini.

Përdorimi i gjerë i së drejtës së pakufizuar nga partitë politike për të zëvendësuar anëtarët e saj në komisionet zgjedhore të niveleve të mesme dhe të ulta sipas dëshirës dhe pa asnjë shkak ligjor (Nenet 32.2 dhe 39.2 të Kodit Zgjedhor) jo vetëm që ndikuan në mënyrë të konsiderueshme mbi pavarësinë, profesionalizmin dhe efikasitetin e administrimit të zgjedhjeve, por edhe patën një ndikim negativ mbi integritetin e procesit zgjedhor. Përputhshmëria e këtyre dispozitave me praktikën e mirë zgjedhore është në pikëpyetje.⁸ Partitë përdorën gjerësisht të drejtën e tyre për të zëvendësuar anëtarët e KZAZ-së, gjë që rezultoi në zëvendësimin e shumë prej anëtarëve të KZAZ-së, përfshirë kryetarët, zëvendës kryetarët dhe sekretarët, gjatë javëve përpara ditës së zgjedhjeve dhe, në disa raste, edhe në ditën e zgjedhjeve si dhe më pas. Këto zëvendësime ndikuan negativisht në punën e shumë prej KZAZ-ve duke qenë se nuk mund të trajnoheshin të gjithë anëtarët.

⁸ Në Dokumentin për Angazhimet Ekzistuese të OSBE/ODIHR-it për Zgjedhje Demokratike në Shtetet Pjesëmarrëse në OSBE, Pjesa 2 e saj, Paragrafi 4.2, thuhet: “Caktimi i pozicioneve administruese zgjedhore në të gjitha nivelet duhet që të kryhet në mënyrë transparente, dhe të emëruarit nuk duhet të largohen nga pozicionet e tyre përpara skadimit të mandatit të tyre, me përjashtim arsyesh ligjore.” Ndërsa në Kodin e Praktikës së Mirë për Çështjet Zgjedhore, përpiluar nga Komisionit i Venecias, 3.1 paragrafi 77, thuhet se: “...organet që caktojnë anëtarë në komisionet zgjedhore nuk duhet të kenë lirinë për t'i tërhequr ata mbrapsht, duke qenë se kjo hedh dyshime mbi pavarësinë e të emëruarave. Tërheqja e tyre pa shkak është e papranueshme, ndërsa tërheqja e tyre për arsye disiplinuese lejohet, me kusht që arsyet të jenë qartësisht dhe tërësisht të përshkruara në ligj.”

Emërimi i KQV-ve mbaroi jashtëzakonisht vonë, shpesh vetëm në prag të ditës së zgjedhjeve. Pavarësisht kërkesës ligjore që emërimet në KQV të përfundonin jo më vonë se 20 ditë para ditës së zgjedhjeve, partitë politike nuk i dhanë ato deri vonë, duke argumentuar që të emëruarit e tyre mund të korruptoheshin ose të detyroheshin nga partitë konkurruese. Disa nga deficitet dhe problemet e raportuara nga vëzhguesit e MNVZ-së ditën e zgjedhjeve mund t'i atribuohen mungesës së trajnimeve si pasojë e emërimeve të vonuara të anëtarëve të KQV-ve. Në disa qendra votimi, hapja e votimit u vonua si pasojë e zëvendësimeve të anëtarëve të KQV-ve minutën e fundit.

Caktimi i vendndodhjeve të qendrave të votimit u pengua deri diku nga ndarja e përgjegjësiive ndërmjet Kryetarëve të Bashkive të Njësiive të Qeverisjes Vendore (NJQV), KQZ-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC) e Ministrisë së Brendshme (MB). Vetëm 61 nga 384 kryetarët e bashkive i përmbushën detyrimet e tyre dhe dorëzuan në KQZ së bashku me hartat e rrethinave, vendndodhjet e qendrave të votimit, si dhe kategorizimin e listave të zgjedhësve sipas qendrave të votimit. Vendndodhjet e disa prej qendrave të votimit u caktuan pas afatit ligjor dhe lidhur me to u debatua gjatë në KQZ. Anëtarët e KQZ-së të emëruar nga opozita dhe përfaqësuesit e partive opozitare argumentuan që qendrat e votimit nuk duhet të vendoseshin brenda pronave private dhe deklaruan se pronarët në fjalë ishin shpesh mbështetës të PD-së, gjë që mund të kishte efekt frikësues mbi votuesit që mbështetnin opozitën. Shumica e anëtarëve të KQZ-së pohonin se atje ku ishin përzgjedhur vendndodhjen brenda pronave private, nuk gjendeshin godina të përshtatshme publike, dhe se sipas Kodit Zgjedhor, vendndodhjet e qendrave të votimit duhet të mbeten të pandryshuara nga njëra zgjedhje tek tjetra, kurdo që kjo të ishte e mundur.

Autoriteti i KQZ-së dhe kontrolli i saj mbi KZAZ-të ishte i kufizuar. Kjo u bë e dukshme ditën e zgjedhjeve dhe veçanërisht gjatë numërimit të votave. Me argumentin se mbikëqyrja e procesit të votimit dhe numërimi i votave ishte përgjegjësi e KZAZ-ve, KQZ-ja nuk përdori autoritetin e saj të plotë për të adresuar problemet që lindën gjatë numërimit të votave, edhe pse u dërguan inspektorë në VNV-të ku numërimi ishte veçanërisht problematik. Shumë prej problemeve që dolën gjatë numërimit të votave si qasja jo konsistente e KZAZ-ve lidhur me vlefshmërinë e votave, ose bllokimi i procesit të numërimit mbi baza procedurale në disa prej VNV-ve, mund të ishin parandaluar, në rast se KQZ-ja do të kishte dhënë më shumë këshillim ligjor, si edhe udhëzime më të plota dhe më specifike.

Në përgjithësi, mbledhjet e KQZ-së ishin transparente dhe u zhvilluan me profesionalizëm. Gjatë tyre Kryetari u përpoq që të mbante balancën mes anëtarëve të KQZ-së dhe gjithmonë konsultoi përfaqësuesit e partive politike. Gjithsesi, KQZ-ja shpesh u nda sipas linjave politike mazhoritare-minoritare, veçanërisht mbi çështjet më të debatuar. Mbledhjet e KQZ-së shpesh u karakterizuan pa qenë nevoja nga interpretime të gjata dhe të përsëritura të ligjit dhe deklarata personale dhe politike, parashtruar si nga anëtarët e KQZ-së, ashtu edhe nga përfaqësuesit e partive. Ky politizim pati ndikim mbi punën e KQZ-së, veçanërisht në detyrën e saj për t'i administruar zgjedhjet në një mënyrë asnjansë dhe efikase.

VI. REGJISTRIMI DHE IDENTIFIKIMI I ZGJEDHËSVE

Në vitin 2008 dhe në muajt para zgjedhjeve, Qeveria ndërmori dy reforma të rëndësishme administrative, që u zbatuan nga Ministria e Brendshme (MB). I pari ishte përfundimi i bazës së të dhënave të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të mbajtur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe caktimi i një numri personal identifikimi çdo qytetari deri në fund të 2008-ës. Reforma e dytë synonte pajisjen e çdo qytetari me një dokument personal identifikimi, një kartë identifikimi të sigurisë së lartë që do të përmbante të dhëna biometrike. Që

të dyja këto reforma patën ndikim të rëndësishëm mbi zgjedhjet dhe adresuan disa rekomandime të mëparshme të OSBE/ODIHR-it. Këto përkuan gjithashtu me masa të cilat Qeveria ishte angazhuar për t'i përmbushur, në përputhje me marrëveshjen udhërrëfyese me Komisionin Evropian mbi liberalizimin e vizave, e cila u firmos në qershor 2008.

A. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE

Për herë të parë në historinë e zgjedhjeve në Shqipëri, listat e zgjedhësve u hartuan mbi bazën e të dhënave qendrore të kompjuterizuara të RKGJC-së. Në të kaluarën, listat e zgjedhësve hartoheshin pak përpara zgjedhjeve bazuar në dokumentacionin e mbajtur në letër nga Zyrtat vendore të Gjendjes Civile (ZGJC). Sistemi i vjetër nuk lejonte korrigjim të gabimeve në shkallë kombëtare për personat e lënë jashtë dhe atyre të shkruar dy herë. Kjo përbënte një pengesë madhore në përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të regjistrimit civil dhe listave të zgjedhësve.

Listat Paraprake të Zgjedhësve u shpallën publikisht në qendrat e votimit, por mund të kontrolloheshin në mënyrë individuale edhe në faqet e internetit të Ministrisë së Brendshme dhe KQZ-së. Pas një periudhe rishikimi dymujore, gjatë të cilës kërkesat e qytetarëve për korrigjime duhet të reflekttoheshin në bazën e të dhënave, më 29 maj 2009 u hartuan Listat Përfundimtare të Zgjedhësve (LPZ) nga baza e të dhënave qendrore nga ZGJC-të dhe iu dërguan KZAZ-ve. KQZ-ja dhe subjektet zgjedhore morën një kopje elektronike të së gjithë listës së zgjedhësve dhe kopje të printuara të listave për secilën NJQV, duke lejuar në këtë mënyrë partitë që të kontrollonin listat. Përveç vonesave të shkaktuara nga funksionimi me vonesë i KZAZ-ve dhe nga vështirësitë logjistike (veçanërisht në rrethet e Dibrës dhe Beratit), listat e zgjedhësve u përditësuan dhe u hartuan në përputhje me dispozitat dhe afatet kohore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

Listat Përfundimtare të Zgjedhësve përmbanin 3,084,067 emra, ose 88,690 më pak se në Listat Paraprake të Zgjedhësve. Përfshirë emrat e shtuar në listën me vendim gjykate, 3,084,946 shtetas kishin mundësi të ushtronin të drejtën e tyre për të votuar. PS-ja kundërshtoi rreth 8,600 emra, më së shumti regjistrime të dyfishta, emra njerëzish me moshë mbi 110 vjeç, dhe emra personash të cilët nuk mbanin më shtetësinë shqiptare. RKGJC-ja u shpreh se kërkesat ligjore dhe kufizimet në programet kompjuterike nuk lejuan pastrimin e LPZ-ve pas shpalljes së tyre.⁹

Si rregull, personat me të drejtë vote përfshihen në listën e zgjedhësve të qendrës së votimit në bazë të vendbanimit të tyre. Kodi Zgjedhor lejon mundësinë për disa kategori votuesish të cilët mund të përfshihen në listat e zgjedhësve të qendrave të veçanta të votimit, përfshirë burgjet, qendrat e votimit në ambientet e paraburgimit, spitalet, dhe repartet ushtarake. Zgjedhësit në këto lista hiqen nga lista e zgjedhësve pranë vendbanimit të tyre. Në disa raste, administrata e burgjeve hartoi lista jo të plota zgjedhësish (burgjet e Lezhës dhe të Durrësit), kurse drejtuesit e institucioneve të tjera (spitali i burgut në Tiranë, një repart ushtarak në Poshnjë, rrethi i Beratit) nuk dorëzuan fare lista zgjedhësish, duke u mohuar të drejtën e votës disa qindra personave.¹⁰

Ditën e zgjedhjeve, vëzhguesit e MNVZ-së raportuan se në 26 për qind të qendrave të votimit të vizituara disa votues ishin kthyer mbrapsht për shkak se emri i tyre nuk ishte në listën e

⁹ Ligji për Gjendjen Civile, datë 10 tetor 2002, lejon shuarjen e emrave nga regjistrat e ZGJC-ve vetëm kur vdekja e personit që nuk është njoftuar nga ana e të afërmeve, konfirmohet me vendim gjykate. Një ndryshim i kohëve të fundit (Ligji nr. 10129, datë 11 maj 2009, "Për Gjendjen Civile", në fuqi që nga 1 qershori 2009) përcakton një procedurë më të thjeshtë, më të besueshme dhe të zbatueshme për shuarjen e emrave të qytetarëve më të vjetër se 100 vjeç, me periudha raportimi në ZGJC çdo muaj.

¹⁰ Për shkak të dorëzimit me vonesë të listave të zgjedhësve nga ana e drejtorëve të burgjeve në Fushë-Krujë dhe Shënkoll, KQZ-ja, më 24 qershor mori vendimin e jashtëzakonshëm për printimin e 698 fletëve shtesë të votimit. Sipas Nenit 97.4 të Kodit Zgjedhor, numri fletëve të printuara për secilën qendër votimi është i barabartë me numrin e zgjedhësve të regjistruar plus një rezervë prej dypërqindësh.

zgjedhësve. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2005 vëzhguesit e MNVZ-së raportuan mbi raste të ngjashme në 51 për qind të qendrave të votimit të vizituara.

B. IDENTIFIKIMI I ZGJEDHËSVE

Gjatë zgjedhjeve të mëparshme, zgjedhësit pa pasaportë të vlefshme përdornin të ashtëquajturat certifikata lindjeje me fotografi për t'u identifikuar. Mungesa e dokumenteve të besueshme të identitetit çoi vazhdimisht në pretendime dhe akuza për keqpërdorime dhe manipulime me prapavijë politike. Prandaj, pajisja e çdo votuesi me një dokument identiteti të besueshëm u pa si një nga hapat thelbësorë në përmirësimin e procesit zgjedhor dhe ishte një nga prioritetet e qeverisë.

Për të votuar ishte e nevojshme që votuesi të paraqiste ose një pasaportë të vlefshme, ose kartën e re të identitetit. Nga përafërsisht 3.1 milion votues të regjistruar, rreth 730,000 nuk kishin pasaportë. Përpjekjet për pajisjen e qytetarëve me karta të reja identiteti filluan më vonë nga ç'ishte parashikuar. Më 12 Janar u hap qendra e parë për aplikime në Tiranë. Shtrirja e procesit të shpërndarjes në të gjitha rrethet u shty përtej kalendarit fillestar. Kjo vonesë solli rrezikun që jo të gjithë qytetarët pa pasaportë do të ishin në gjendje të aplikonin dhe të merrnin një kartë të re identiteti në kohë, dhe për këtë arsye nuk do të ishin në gjendje të votonin. Përsheptimi i lëshimit të kartave të identitetit u kthye në një 'mollë shërri', gjë që u reflektua edhe në fushatën zgjedhore të disa partive.

Duke pasur parasysh kufizimet e ndryshme, fushata për pajisjen e qytetarëve me karta të reja identiteti ishte në përgjithësi e suksesshme dhe vendosi themelet për një sistem solid të identifikimit të zgjedhësve. Qeveria e mbështeti procesin e shpërndarjes së kartave të identitetit përmes një fushate të informimit publik, përmes zgjatjes së orarit të punës të qendrave të aplikimit dhe vendosjes së skemës së subvencionimit për të ndihmuar zgjedhësit në pagesën e tarifës së aplikimit. Në total, deri më 18 qershor pati 1,402,361 aplikime për kartë të re identiteti. Kjo datë ishte edhe dita e fundit kur mund të dorëzoheshin aplikimet, në mënyrë që karta e re e identitetit të merrej përpara ditës së zgjedhjeve. Nga këto, 472,236 nuk kishin pasaporta. Numri i kartave të identitetit të tërhequra nga aplikuesit deri ditën e zgjedhjeve ishte 1,321,376.

Periudha e shkurtër kohore dhe përfshirja e 354 administratave të NJQV-ve, si edhe koha shumë e shkurtër në dispozicion për të trajnuar personelin administrativ, sollën si rezultat deficite në menaxhim dhe në kapacitete. I gjithë operacioni bazohej mbi një teknologji e cila ishte e ndjeshme ndaj mungesave në infrastrukturë, gjë që u bë më shumë e dukshme në rrethet më periferike të vendit.

Administrimi i procesit u kritikua nga opozita, veçanërisht për çështjet e mëposhtme: tarifa e aplikimit prej 1,200 lekësh të reja (rreth 9 euro), të cilën ata e konsideronin tepër të lartë; skema e çmimeve të subvencionuara krijuar për grupe të ndryshme të shoqërisë, dhe aplikimi saj, që sipas opozitës u bë në mënyrë të përzgjedhur; plani operacional i kontraktuesit, me anë të së cilit qendrat e aplikimeve në NJQV më të vogla u hapën vetëm pas datës 15 maj, duke krijuar kështu pengesa për njerëzit që jetonin në zonat e thella; mungesa e shpeshtë e energjisë elektrike, ndërprerjet e internetit, mosfunksionimi i aparaturave dhe ndryshimi i orareve të punës, që opozita i konsideroi si të orkestruara; dhe rimbursim i kostove të udhëtimit për ata aplikues të cilëve u duhej që të udhëtonin për të aplikuar, gjë e cila, sipas opozitës, po përdorej si mjet për të vënë në shënjestër një grup të caktuar votuesish.

Tek vëzhguesit afatgjatë të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it mbërritën pretendime të shumta të përfshirjes së padrejtë të aktivistëve të PD-së në proces. Shumica këtyre rasteve u hetuan dhe u verifikuan raste të tilla në rrethet e Vlorës dhe të Korçës.

Nga ana politike, debati më me peshë lidhur me shpërndarjen e kartave të identitetit doli si pasojë e mosdhënies nga ana e MB-së e shifrave të besueshme mbi ecurinë e procesit të aplikimit të shtetasve pa pasaportë. Disa herë përpara ditës së zgjedhjeve, Ministria e Brendshme deklaroi disa të dhëna me shifra, por pasaktësitë në të këto dhëna bënë që opozita të akuzonte qeverinë për manipulim të qëllimshëm dhe që PS-ja të bënte kallëzime penale kundër zyrtarëve të lartë të MB-së.¹¹ Kjo çështje u komplikua edhe më tej duke qenë se sipas vlerësimit të MB-së, nga 729,020 shtetas pa pasaportë, diku nga 160,000 deri në 260,000 gjendeshin jashtë vendit pa dokumente të vlefshme.

Ditën e zgjedhjeve, nuk ishin përpunuar vetëm 3,321 aplikime nga 1,402,361 të dorëzuara; 77,751 karta të reja identiteti mbetën pa u tërhequr. Për më tepër, 256,792 qytetarë, që ishin regjistruar në bazën e të dhënave të personave pa pasaportë të vlefshme, nuk aplikuan për kartë të re identiteti. Ka një mospërputhje domethënëse mes shtetasve meshkuj dhe atyre femra të një moshe të caktuar brenda këtij grupi, sidomos mes atyre të moshës nga 21 deri në 50 vjeç. Ka të ngjarë që shumë gra të cilat janë martuar dhe kanë ndryshuar mbiemrin e tyre, të kenë mbetur të regjistruara në regjistrat vendorë me mbiemrin e tyre të vajzërisë, pra figurojnë dy herë. Ka gjithashtu të ngjarë që dosja të ketë sërish gabime shkaktuar nga përshtatja jo e mirë e programeve kompjuterike me gjuhën shqipe.¹²

Sipas vlerësimit të OJQ-së më të madhe shqiptare e cila kryen lobim për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, mbi 2,000 zgjedhës me aftësi të kufizuara të cilët nuk kanë pasaportë të vlefshme, nuk mundën të aplikojnë për kartën e re të identitetit, për shkak të aksesit të vështirë ose të pamundur në qendrat e aplikimit.¹³ As votuesit që nuk dalin dot nga shtëpia, nuk ishin në gjendje të votonin duke qenë se nuk kishte qendra lëvizëse aplikimi. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u informua se mbi 1,000 familje nuk patën mundësi të votonin si pasojë e gjakmarrjeve, një praktikë ende në vazhdim, për arsye se nuk mund të dilnin nga vendstrehimet e tyre, as për të aplikuar për kartat e reja të identitetit e as për të votuar.

VII. REGJISTRIMI KANDIDATËVE

Partitë politike që dëshirojnë t'i kontestojnë këto zgjedhje, duhej të regjistroheshin si subjekte zgjedhore pranë KQZ-së. Dy ose më shumë subjekte elektorale mund të regjistroheshin se koalicion zgjedhor. Partia që ishte regjistruar si subjekt zgjedhor duhej të dorëzonte listën e kandidatëve të saj sipas zonave jo më vonë se 40 ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Listat e kandidatëve të partive jo parlamentare të cilët konkurronin individualisht, ose të koalicioneve që kishin më pak vende në parlamentin e mëparshëm sesa numri i partive në koalicion, duhej të siguronin 10,000 ose 15,000 firma nga votuesit e regjistruar secili, në shkallë vendi. Kodi lejon gjithashtu individët që të emërohen si kandidatë me propozimin e një grupi votuesish, me mbështetjen e firmave të të paktën një përqind të votuesve të regjistruar në zonën përkatëse

¹¹ Baza e të dhënave u publikua më 2 maj, 26 dhe 28 maj dhe më 23 qershor. Drejtori i RKGJC-së pohoi se grupi i dytë dhe i tretë i të dhënave kishte mungesa.

¹² Programi kompjuterik i përdorur fillimisht nuk lejonte përdorimin e plotë të alfabetit të gjuhës shqipe. Dy nga shkronjat e përdorura në alfabetin shqiptar, 'ë' dhe 'ç', u zëvendësuan me 'e' dhe 'c', duke krijuar kështu një sërë gabimesh ose dyfishimesh.

¹³ Znj. Mybere Prizreni, Presidente e Shoqatës së Paraplegjikëve dhe Tetraplegjikëve të Shqipërisë bisedoi me MVZ-në e OSBE/ODIHR-it

zgjedhore. Votuesit duhej që t'i depozitonin firmat e tyre në mbështetje të kandidatëve në KQZ ose përpara një noteri. Një votues mund të mbështeste vetëm një parti ose një kandidat.

45 parti u regjistruan si subjekte zgjedhore në KQZ. Një total prej 36 partish depozituan listat e kandidatëve në KQZ. Nga këto, 33 ishin pjesë e një koalicioni.¹⁴ Përveç partive politike, KQZ-ja regjistroi edhe tre komitete nismëtare për kandidatë të mbështetur nga një grup votuesish. Dy prej tyre dorëzuan dokumentacionin e kërkuar për kandidim dhe firmat mbështetëse. Në një proces përfshirës, KQZ-ja fillimisht miratoi listën e kandidatëve të 35 partive dhe kandidaturën e një kandidati, i cili ishte emëruar nga një grup votuesish.

Shumica e partive kishin dorëzuar lista kandidatësh që u desh të ktheheshin mbrapsht, veçanërisht për shkak të dokumentacioneve të pasakta ose jo të plota¹⁵, apo për mosshlyerjen e kërkesave ligjore në lidhje me gjininë. Data 29 maj ishte data e fundit, kur KQZ-ja shqyrtoi listat e korigjuara. Partia Socialiste ishte e vetmja parti që i dorëzoi listat e kandidatëve të saj pas afatit të mesnatës më 19 maj.¹⁶ PS-ja deklaroi se nuk kishte pasur njeri në KQZ që t'i pranonte listat, çka u kundërshtua nga KQZ-ja. Gjithsesi, KQZ-ja në mënyrë unanime votoi për pranimin e listave të kandidatëve të PS-së.

Partia e Punës së Shqipërisë e Riorganizuar (PPRSH) falsifikoi nënshkrimin e një notereje, duke deklaruar se 10.000 firmat mbështetëse ishin depozituar pranë saj. Pasi përfaqësuesi i PS-së në KQZ solli një deklaratë të nënshkruar nga noterja në fjalë, në të cilën ajo mohonte që të kishte qenë e pranishme gjatë depozitimit të firmave, KQZ-ja vendosi ta hiqte PPRSH-në nga fleta e votimit.

“Aleanca për Ndryshim” u regjistrua si koalicion i 17 partive, përfshirë PD-në e Kryeministrit Sali Berisha. Parti të tjera në koalicion që përfaqësoheshin në Kuvendin të cilit po i mbaronte mandati, ishin Partia Republikane, Partia Agrare Ambientaliste, Partia e Aleancës Demokratike dhe Bashkimi Demokratik Liberal. Po ashtu, përfshihej edhe Partia për Drejtësi dhe Integrim. Koalicioni “Bashkimi për Ndryshim” përbëhej nga pesë parti, përfshirë PS-në, Partinë Social Demokratike dhe Partinë e Demokracisë Sociale, të cilat kishin deputetë në këtë katërvjeçar të Kuvendit që po i mbaronte mandati. Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut kishte marrë pjesë në qeverinë e udhëhequr nga PD-ja, por përpara afatit për regjistrimin e koalicioneve u bashkua me koalicionin e udhëhequr nga PS-ja. Koalicioni “Bashkimi për Ndryshim” përfshiu edhe një parti të re, G99-ën, e cila u krijua nga figura të njohura të shoqërisë civile.

“Aleanca Socialiste për Integrim” ishte një koalicion prej gjashtë partish i udhëhequr nga Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI). Në këtë koalicion u përfshi edhe Partia Socialiste e Vërtetë '91, një parti që u krijua në fillim të vitit 2009 pas një ndarjeje brenda PS-së. “Poli i Lirisë” me gjashtë parti, një koalicion i themeluar në prill 2009, ishte një koalicion i qendrës së djathtë. Në të u përfshinë Lëvizja për Zhvillim Kombëtar dhe Partia Demo-Kristiane, e cila në zgjedhjet e vitit 2005 kishte qenë pjesë e bllokut të udhëhequr nga PD-ja.

VIII. FUSHATA ZGJEDHORE

Zgjedhjet u zhvilluan në një klimë politike tejet të polarizuar. Shumë parti opozitare shprehën mosbesim të thellë ndaj autoriteteve shtetërore dhe administratës zgjedhore. Fushata u dominua

¹⁴ Lista e kandidatëve nuk u dorëzua nga një parti në koalicionin e udhëhequr nga PD-ja.

¹⁵ Në shumicën e këtyre rasteve, kandidatët kishin paraqitur kopje të pasaportave të tyre të skaduara si dokument identifikimi.

¹⁶ Në orën 08:00 më 20 maj, sipas Libër Protokollit të KQZ-së.

pjesërisht nga diskutimet në lidhje me shpërndarjen e letërnjoftimeve të reja (kartat e identitetit). Në veçanti, PS-ja u fokusua në procesin e shpërndarjes së letërnjoftimeve dhe pretendoi që zgjedhjet do të delegjitimoheshin nëse një numër i madh zgjedhësish nuk do të pajiseshin me letërnjoftime duke mos pasur kështu mundësi për të votuar. Opozita akuzoi gjithashtu qeverinë për nxjerrjen e të dhënave të rreme në lidhje me shpërndarjen e letërnjoftimeve.

Periodha zyrtare e fushatës nisi më 28 maj. Klima e fushatës ishte kryesisht e qetë, pavarësisht disa incidenteve të dhunshme, sidomos në qarkun e Korçës.¹⁷ Të gjitha partitë mund të bënin fushatë lirisht në të gjithë vendin, ndërsa fushata e PD-së dhe PS-së ishte më e shtrirë. Në veçanti drejtues të njohur politikë udhëtuan dhe zhvilluan takime në të gjithë vendin. Në shumë qarqe u ngritën zyra vendore të fushatës, edhe pse fushata ishte e kufizuar në disa zona. Edhe pse të gjitha partitë, përveç një partie, kandiduan si pjesë e një koalicioni, fushatën e zhvilluan kryesisht të ndarë dhe jo të bashkuar me koalicionin. Vetëm Poli i Lirisë zhvilloi fushatën si një koalicion.

PD-ja theksoi arritjet e saj në qeveri, si dhe qëllimet për një mandat të ardhshëm, duke u përqendruar në fusha si integrimi në NATO dhe BE, zhvillimi i infrastrukturës, lufta kundër korrupsionit, reformat në arsim dhe në administratën tatimore. PS-ja theksoi arritjet e drejtuesit të saj, Edi Rama, si Kryebashkiak i Tiranës dhe premtoi se do ta shtrinte këtë sukses në të gjithë Shqipërinë. Fushata me raste u prish nga gjuha tejet e ashpër ndaj kundërshtarëve, por gjithashtu ndonjëherë edhe kundër personaliteteve të njohura të partive brenda të të njëjtit koalicion. PD-ja dhe PS-ja hodhën akuzuan korrupsioni ndaj udhëheqësve të partisë kundërshtare.

MVZ (Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve) të OSBE/ODIHR-it mori akuza të shumta, nga shumica e qarqeve, për presion mbi punonjësit e sektorit publik, duke përfshirë kërcënime për largim nga puna, për të marrë pjesë në veprimtari të fushatës së PD-së, ose për të mos shkuar në veprimtari të opozitës. Këto veprime bien në kundërshtim me paragrafin 7.7 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së.¹⁸ MVZ i OSBE/ODIHR-it ndoqi këto akuza dhe vërtetoi shumë prej tyre. Për shembull:

- Punonjësve të bashkive u kërkohet nga eprorët të merrnin pjesë në takimet e PD-së në Peqin (qarku Elbasan) dhe Shkodër.
- Në një shkollë në qarkun e Tiranës, drejtori kërcënoi mësuesit me largim nga detyra nëse nuk votonin për PD-në. Ai u kërkoi të fotografonin fletët e votimit për të provuar votën e tyre.
- Në qarkun e Fierit, një punonjës i sektorit publik që mori pjesë në një aktivitet me një zyrtar të lartë të PS-së, u kërcënua me shkarkim nga detyra.
- Një punonjës i sektorit publik në Kavajë (qarku Tiranë) u paralajmërua se mund t'i rrezikohet vendi i punës nëse përfshihej shumë hapur me Partinë e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut.

MVZ e OSBE/ODIHR-it mori gjithashtu raportime për presion mbi studentët në universitete, si vijon:

- Në Korçë studentët u detyruan të merrnin pjesë në një takim të PD-së dhe u paralajmëruan që nuk do të merrnin provimet, nëse nuk merrnin pjesë.

¹⁷ Incidente të tjera të dhunshme u raportuan tek vëzhguesit e OSBE/ODIHR-it në qarqet Tiranë, Dibër dhe Lezhë.

¹⁸ Paragrafi 7.7 përcakton që shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së do të "sigurojnë që ligji dhe politikat publike të lejojnë që fushata politike të zhvillohet në atmosferë të ndershme dhe të lirë, ku as veprimet administrative, as dhuna apo kërcënimi të mos pengojnë partitë dhe kandidatët të shprehin lirshëm mendimet dhe cilësimet e tyre; dhe të mos parandalojnë votuesit që të mësojnë dhe të diskutojnë rreth këtyre mendimeve, dhe që ta hedhin votën e tyre pa frikë nga hakmarrja."

- Në qarkun e Elbasanit, një nëpunës i lartë i kërkoi një aktivisti të ri të LSI-së të mos punonte për LSI-në dhe e paralajmëroi që të afërmit e tij mund të mos merrnin shkollën dhe se i ati i tij mund të pushohej nga puna.

Qeveria përdori në mënyrë të përsëritur aktivitete zyrtare për qëllime fushate, duke e zbehur dallimin ndërmjet veprimtarive të shtetit dhe fushatës, në kundërshtim me paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së.¹⁹ Inaugurimet e projekteve të infrastrukturës nga Kryeministri dhe nëpunës të tjerë të lartë të PD-së ndodhën shumë shpesh gjatë periudhës parazgjedhore, si dhe shumë afër ditës së zgjedhjeve. Në to morën pjesë turma të mëdha që valëvisnin flamujt e PD-së, ndërsa fjalimet kishin karakter shumë të qartë fushate. Për shembull:

- Kryeministri inauguroi një hidrocentral në Bushat (qarku Shkodër) më 23 maj, ku u kërkua prezenca e punonjësve të bashkisë dhe mësuesve, dhe një hidrocentral tjetër në qarkun Elbasan më 8 qershor.
- Kryeministri inauguroi një seksion të rrugës Durrës-Kukës më 25 qershor në prani të kryeministrave të Turqisë dhe të Kosovës. Në këtë veprimtari, podiumi i ngritur për folësit mbante moton e fushatës së PD-së.

Pati akuza që disa inaugurime ishin të fabrikuara. Për shembull, vëzhguesit e OSBE/ODIHR-it konstatuan që një maternitet i saporinovuar në Durrës i inauguruar nga Kryeministri, nuk ishte vënë në funksion. Kryetari i Bashkisë të Tiranës përdori gjithashtu veprimtari zyrtare për të bërë fushatë për PS, por shumë më rrallë. Në veçanti, një aktivitet në Ditën Botërore të Muzikës, i organizuar nga Bashkia e Tiranës, mbante numrin “33” në skenë, numri i PS-së në fletën e votimit.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it mori akuza të ndryshme për shkollat që mbylleshin, sepse nxënësit duhej të merrnin pjesë në inaugurime ose veprimtari të PD-së. Disa u verifikuan, përfshirë këtu dhe inaugurimin e hidrocentralit në qarkun e Elbasanit më 8 qershor dhe një miting të PD-së në Korçë më 5 qershor.

Pati akuza që PD-ja keqpërdori për qëllime fushate burimet administrative, si automjetet e punës dhe ndërtesat zyrtare, apo edhe punonjësit e sektorit publik, në shkelje të Kodit Zgjedhor (sidomos Nenet 3.7 dhe 88). Në Shijak (qarku Durrës), Elbasan dhe Korçë, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it konstatoi kamionë të kompanisë OSSH, e cila është dega private e shpërndarjes të ofruesit publik të energjisë, KESH-it, që vendoste flamuj dhe postera të PD-së dhe në një rast, që hiqte ato të PS-së. Në Elbasan, ftesat për një miting të PD-së u shpërndanë së bashku me postën, sipas udhëzimit të drejtorit të një poste.

Dispozitat për vendosjen e posterave dhe flamujve të fushatës nuk u zbatuan në vijueshmëri, duke çuar në debate në disa qarqe. Sipas Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimit Nr 14 të KQZ-së, autoritetet vendore duhej të caktonin hapësira publike për posterat politike dhe të informonin subjektet zgjedhore në lidhje me to. Në shumë raste, partitë nuk u informuan për hapësirat e caktuara. Në disa raste, kjo çoi në heqjen e posterave dhe përballje të dhunshme. Në Tiranë, pati mosmarrëveshje nëse vendosjen e materiale të fushatës duhej ta miratonte kryetari i bashkisë apo kryetari i njësisë bashkiake. Në incidentin më të rëndë, një konflikt për vendosjen e posterave rezultoi në qëllimin me armë për vdekje të një aktivisti të PD-së nga një aktivist i PS-së në Qerret, afër Durrësit, më 12 qershor. Të dyja partitë bënë thirrje për qetësi dhe minimizim të aspektit politik të ngjarjes.

¹⁹ Paragrafi 5.4 i Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së në vitin 1990 përcakton “një ndarje të qartë ndërmjet shtetit dhe partive politike.”

Stendat dhe tendat e fushatës shkaktuan gjithashtu debate. Një tendë e G99-s në Kamëz (qarku Tiranë) u dëmtua nga policia më 21 maj dhe në 4 qershor kryetari i njësisë 6 në Tiranë hoqi një tendë të PS-së. Kryetari i Bashkisë së Shkodrës ndoqi një mënyrë kufizuese, bazuar në Ligjin për Urbanizimin, që në këtë rast nuk u duk të ishte i zbatueshëm. Një stendë e G99-s u hoq nga policia bashkiake dhe partia u gjobit. Stenda të G99-s u raportuan të hequra edhe në dy vende të tjera të qarkut.

FINANCIMI I FUSHATËS

Subjekteve zgjedhore u caktohen fonde publike për fushatë. Pesëdhjetë përqind e fondeve iu shpërndahen të gjitha subjekteve zgjedhore që kanë pasur mandate në parlamentin e shkuar, në raport me numrin e vendeve në parlament. Pjesa tjetër prej 50 përqind u shpërnda mes partive që fituan jo më pak se dy vende në zgjedhjet e fundit parlamentare, në raport me numrin e votave që morën në mbarë vendin. Partive që marrin fonde sipas shpërndarjes së dytë, të cilat nuk sigurojnë vende në parlamentin e ri, u kërkohet që t'ia kthejnë këtë shumë KQZ-së, e cila më pas i shpërndahet sërish partive që fituan mandate.

Kodi Zgjedhor tani ngarkon KQZ-në (Nenet 89-92) të mbikëqyrë rregullat për financimin e fushatës nëpërmjet fondeve publike dhe jopublike. Subjekteve zgjedhore u kërkohet të regjistrojnë fondet që marrin, si dhe hapjen e llogarive të veçanta bankare për donacione më të mëdha se 100.000 lek (rreth 770 euro). Jo më vonë se 45 ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, KQZ cakton ekspertë kontabël të kontrollojnë fondet e marra dhe shpenzimet për vetë fushatën. Ndërsa këto dispozita janë një përmirësim i mirëpritur, transparenca e procesit do të rritej nëse do të kishte dispozita për deklarimin e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë fushatës. Ndërsa neni 91 i Kodit përcakton që KQZ mund të bëjë vetë verifikime të raporteve financiare të subjekteve zgjedhore, ai nuk përmban kritere për kryerjen e këtyre kontroleve. KQZ është përgjegjëse për të paguar auditët e caktuar, por ka fonde të kufizuara në dispozicion për këtë qëllim.

IX. MEDIA

A. SFONDI I PËRGJITHSHËM MEDIATIK

Këshilli Kombëtar i Radio-Televizionit (KKRT) ka licencuar tri stacione televizive komerciale me shtrirje kombëtare, 69 stacione televizive lokale dhe 50 stacione televizive kabllore.²⁰ Pjesa reale që kanë në treg këto transmetues nuk dihet, pasi mungojnë studime që të jenë si sistematike, ashtu edhe të besueshme në lidhje me masën e shikuesve. Njëzetë e një gazeta ditore konkurrojnë për një numër lexuesish që besohet të jetë më i vogël se 60,000 vetë.²¹ Për shkak të numrit të madh të mediave që konkurrojnë në një treg të kufizuar reklamash (me një shifër të përafërt prej 21 milion eurosh në vit)²², transmetuesit mediatikë nuk marrin të ardhura të mjaftueshme nga burime të qëndrueshme financiare dhe varen më së shumti nga financimet e dhëna nga biznesi. Në përgjithësi dihet pronësia e transmetuesve më të rëndësishëm, përfshirë edhe gazetatat më të rëndësishme ditore, por burimet për financimin e tyre vazhdojnë të mos jenë transparente. Struktura e tregut të reklamave është e një forme të tillë që lejon që disa

²⁰ Shiko www.kkrt.gov.al.

²¹ Sipas Nenet 19, një Organizatë Jo-Qeveritare, e cila merret me çështjet e medias www.article19.org/pdfs/publications/self-regulation-south-east-europe.pdf.

²² Sipas Bordit të Shkëmbimit të Studimeve Ndërkombëtare (IREX) që punon për fuqizimin e medias së pavarur, shiko www.irex.org/programs/MSI_EUR/2009/albania.asp.

transmetues reklamash, si autoritete publike²³ apo kompani të mëdha²⁴, të influencojnë politikat editoriale. Mediat më të rëndësishme televizive dhe ato të shkruara konsiderohen si të angazhuara me njërin prej dy partive kryesore politike.

Cilësia editoriale pengohet nga ndërhyrjet e politikanëve, grupeve të ndryshme lobiste të biznesit dhe pronarët e mediave me interesa politike apo ekonomike. Gazetarët dhe media, për shkak të rreshtimit të tyre politik, i minimizojnë deri në autocensurë aspektet e ndryshme të lajmeve, apo vënë më në pah ato elementë që janë në përputhje me aleancat e tyre politike apo komerciale.²⁵ Përveç këtyre, në autocensurën e gazetarëve ndikojnë edhe sanksionet penale për fyerjen dhe shpifjen.²⁶ Ndërkohë që mungesa e kulturës së vetërregullimit dhe situata e punësimit të pambrojtur të shumicës së gazetarëve²⁷ dëmton standardet editoriale dhe etikën në gazetari.

Përgjegjësia sociale për t'u siguruar që pluralizmi mbetet tek transmetuesi publik. Transmetuesit që marrin fonde publike duhet të japin një atmosferë të plotë dhe asnjansë të të gjithë spektrit politik gjatë reflektimit të zgjedhjeve, meqenëse ata janë të detyruar të ofrojnë një gamë të gjerë pikëpamjesh e mendimesh të ndryshme e pluraliste.²⁸ Duhet të vazhdojë reforma e transmetuesit publik, Radio-Televizionit Shqiptar (RTSH), që mbulon edhe pjesën më të madhe të territorit të vendit. RTSH-ja mbetet ende në varësi të financimeve nga buxheti i shtetit, duke qenë se vetëm nëntë përqind të të ardhurave të saj vijnë nga taksa vjetore. Ndërhyrjet me qasje politike janë veçanërisht të dukshme pas ndryshimeve në Qeveri. Pas zgjedhjeve të vitit 2005, koalicioni fitues i udhëhequr nga PD-ja ndryshoi Komitetin Drejtues të KKRT-së, si edhe personelin menaxhues dhe disa nga punonjësit e tjerë të Televizionit Shqiptar (TVSH). Më shumë se 80 punonjës të TVSH-së u larguan nga puna.

B. RREGULLAT PËR FUSHATËN DHE PASQYRIMI I SAJ NË MEDIA

Kodi Zgjedhor ka rregulla të hollësishme për pasqyrimin e fushatës zgjedhore në edicionet e lajmeve dhe programet informative si të transmetuesve publikë, ashtu edhe të atyre privatë. Në Kod përcaktohet koha falas që u jepet partive politike në radiot dhe televizionet private, si edhe kufizimi për kohën e paguar të transmetimit që mund të blejnë subjektet politike në transmetuesit

²³ Një burim i konsiderueshëm të ardhurash për median janë reklamat apo njoftimet e ndryshme, që bëhen nga qeveria. Ndaj, qeveritë gjithnjë e më shumë akuzohen se nxjerrin më shumë njoftime publike në media që janë më afër tyre dhe që i favorizojnë ato në pasqyrimet që bëjnë. Monitorimi i medias nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it dy javët përpara fillimit zyrtar të fushatës tregoi se spotet televizive me tematikë qytetare që u lançuan nga ministrinë apo agjencitë e ndryshme shtetërore, që mund të interpretoheshin si fushatë në favor të PD-së, u shfaqën më së shumti në televizionin publik (30 përqind) dhe në televizionin TV Klan (48 përqind), kanale këto që janë më afër PD-së, më pak në Top Channel (22 përqind), dhe aspak në dy kanalet e tjera televizive që monitoroheshin, të cilat dukeshin të ishin më kritike ndaj Qeverisë.

²⁴ Për shembull, kompanitë e telefonisë celulare, të cilat për disa vite rresht bllokuan publikimin e kritikave për çmimet e tyre të larta monopol (shih www.irex.org/programs/MSI_EUR/2009/albania.asp).

²⁵ Kjo u bë e qartë, mes të tjerash, në pasqyrimin që iu bë raporteve të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it nga mediat e monitoruara. U nxorën jashtë konteksti shifrat, u injoruan kritikrat dhe u përdorën për tituj të rreme konkluzione individuale.

²⁶ Kodi Penal parashikon pesë dispozita ligjore në lidhje me veprën penale të fyerjes dhe shpifjes: fyerje e thjeshtë, shpifje e thjeshtë, ofendim ndaj zyrtarëve publikë në lidhje me funksionin publik që mbajnë, shpifje ndaj zyrtarëve publikë në lidhje me funksionin publik që mbajnë, dhe shpifje ndaj Presidentit të Republikës. Duke qenë se në Kodin Penal nuk jepet përkufizimi i fjalës “fyerje”, në Shqipëri gjykatat kanë qenë të lira të nxirrin interpretimin e tyre në lidhje me të. Disa ndryshime ligjore priten të shqyrtohen në Parlament për depenalizimin apo dekriminalizimin e veprës penale të fyerjes dhe shpifjes.

²⁷ Sipas Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, në 2005-n, rreth 95 përqind të gazetarëve në Shqipëri punonin duke mos pasur kontrata apo sigurime shoqërore.

²⁸ Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave, Rekomandimi Nr 15 R (99) i Komitetit të Ministrave dërguar Shteteve Anëtare për Masat në lidhje me Pasqyrimin e Fushatave Zgjedhore në Media (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 9 shtator 1999 në takimin e 678¹⁶).

privatë. Dispozitat kanë të bëjnë vetëm me fushatën zgjedhore, e cila fillon 30 ditë përpara ditës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë përpara kësaj date. Bordi Monitorues i Medias (BMM) ngrihet nga KQZ-ja me caktimin e një anëtarit të BMM-së nga çdo anëtar i KQZ-së. BMM-ja, e cila është i vetmi ent që mbikëqyr median transmetuese gjatë fushatës zgjedhore, mbështetet në kapacitetet teknike të KKRT-së për të kryer punën e saj. Sektori monitorues i KKRT-së jep vetëm të dhëna sasiore për kohën që u është vënë në dispozicion subjekteve politike, pra nuk jep të dhëna në lidhje me cilësinë, apo me tonin e pasqyrimin të lajmit. Kjo nuk ndihmon për të përcaktuar nëse transmetuesit i përmbahen detyrimit ligjor për të shfaqur “pluralizëm informacioni”, siç thuhet në Nenin 80.2, apo lihet të kuptohet në Nenin 84 të Kodit Zgjedhor. Monitoruesit e medias u caktuan me vonesë dhe nuk morën trajnimin e duhur. Vëzhguesit afatgjatë të Misionit të OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve raportuan se monitoruesit vendorë²⁹ nuk ishin në gjendje t’i përmbushnin detyrat e tyre, jo vetëm për shkak të mungesës së pajisjeve teknike, por edhe sepse nuk ishin bërë trajnime të plota me ta.

Kodi Zgjedhor parashikon që koha e pasqyrimin të veprimtarive qeveritare që lidhen me fushatën zgjedhore përfshihet në kohën e partisë, së cilës i përket titullari që zhvillon veprimtarinë. Për shkak të mospërcaktimit të qartë në Kodin Zgjedhor, vlerësimi në lidhje me atë se cilat aktivitete qeveritare kanë lidhje me fushatën e cilat nuk kanë, iu la anëtarëve të BMM-së. Veprimtaritë gjatë të cilave Kryeministri pati avantazh duke bërë fushatë në cilësinë e tij institucionale, u polemizuan ndërmjet anëtarëve të BMM-së. Të katër anëtarët e BMM-së të caktuar nga anëtarët e KQZ-së që ishin përzgjedhur nga mazhoranca parlamentare, dhanë mendimin se këto aktivitete ishin institucionale, ndërkohë që tre të tjerët arritën në përfundimin që ato kishin lidhje me fushatën. Deklaratat e ndryshme të anëtarëve të BMM-së treguan një mungesë pavarësie nga anëtarët e BMM-së nga interesat partiake.

Vlerësimet e ndryshme për veprimtaritë, pra nëse ato kishin lidhje me institucionet përkatëse apo me fushatën zgjedhore, patën një ndikim të rëndësishëm në barazinë e sasisë kohore dhënë pasqyrimin të fushatave të PD-së dhe PS-së, dhe për rrjedhojë, edhe në kohën e përgjithshme që i duhej dhënë edhe partive “më të vogla” parlamentare.³⁰ Në raportin e vet për periudhën deri më 24 qershor, BMM-ja deklaroi se një numër i konsiderueshëm transmetuesish nuk i kishte dhënë partive “më të vogla” sasinë kohore të transmetimit që u takonte, por nuk shkoi më tej që të jepte KQZ-së propozime konkrete për masa korrigjuese. Sipas Kodit Zgjedhor, transmetuesit privatë që nuk u përmbahen detyrimeve ligjore, duhen gjobitur. Në vend të kësaj, u morën masa kompensimi për LSI-në dhe PSD-në duke u vënë atyre në dispozicion më shumë kohë në televizion, pasi këto ishin të vetmet parti që dorëzuan kërkesa të këtij lloji. Meqenëse KQZ-ja miratoi edhe sasi të konsiderueshme kohore për kompensim në favor të PD-së dhe PS-së në disa prej kanaleve më të shikuara, ishte e pamundur për transmetuesit që ta rregullonin pasqyrimin në mënyrë që partitë “më të vogla” të merrnin pasqyrimin sasiore që u takonte.

C. MONITORIMI I MEDIAS NGA MISIONI VËZHGUES I OSBE/ODIHR-IT

Që prej datës 14 maj e deri më 28 qershor, Misioni Vëzhgues i OSBE/ODIHR-it monitoroi në mënyrë sasiore dhe cilësore pasqyrimin e fushatës gjatë orëve më të ndjekura në pesë kanale televizive (TVSH-në publike dhe këto kanale private: Vizion+, Top Channel, TV Klan, si edhe News 24, i cili transmeton vetëm lajme). MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it monitoroi edhe pasqyrimin e fushatës në katër gazeta ditore: *Gazeta Shqiptare*, *Shqip*, *Panorama* dhe *55*.

²⁹ U caktuan monitorues vendorë për transmetuesit vendorë, që nuk mbuloreshin nga KKRT-ja.

³⁰ Sipas Kodit Zgjedhor, partive “të mëdha” parlamentare, deputetët e së cilave zënë më shumë se 20 përqind të vendeve në Kuvend, u jepet dy herë më shumë kohë transmetimi se partive “të vogla” parlamentare.

Rezultatet e monitorimit të medias nga ana e OSBE/ODIHR-it treguan se dy javë përpara të fillonte zyrtarisht fushata (14–27 maj), gjatë edicioneve më të shikuara të lajmeve apo programeve të tjera informative³¹ transmetuesit e monitoruar kanë bërë një pasqyrim të njëanshëm dhe jo të balancuar të dy partive kryesore politike, në kundërshtim me dispozitat ligjore.³² Televizioni publik Shqiptar (TVSH) dhe televizioni privat TV Klan treguan animin e tyre me PD-në dhe ishin kritike ndaj opozitës, ndërkohë që tre transmetuesit e tjerë privatë favorizuan PS-në dhe ishin kritikë ndaj PD-së. Neni 41 i Ligjit për Radio-Televizionet Publike dhe Private përcakton se edicionet e lajmeve dhe programet informative që transmetohen nga transmetuesit radio-televizivë duhet t'i pasqyrojnë faktet dhe veprimtaritë në një mënyrë të drejtë dhe të paanshme. Ato, po ashtu, duhet të promovojnë formimin e opinionit të lirë dhe të mos u shërbejnë interesave të ndonjë organizate ose partie politike, grupi ekonomik, apo ndonjë shoqate apo bashkësie fetare. Ndërsa në lidhje me median e shkruar nuk ka legjislacion të hollësishëm.³³

Në Shqipëri ka një larmi gazetash, shumica e të cilave shprehin preferencën e tyre për një parti të caktuar politike. Një gamë pluraliste gazetash shërben për t'i informuar votuesit rreth zgjedhjeve. Gazetat e monitoruara treguan një preferencë të konsiderueshme gjatë periudhës përpara fushatës në lidhje me pasqyrimin e PD-së dhe PS-së. Ndërkohë që të gjitha gazetat e monitoruara ia kushtuan PD-së pjesën më të madhe të hapësirës për lajmet, toni i pasqyrimin ndryshonte nga njëra gazetë tek tjetra. Të gjitha gazetat e monitoruara, përveç 55-ës treguan njëanshmëri në favor të PS-së.³⁴

Monitorimi i medias i kryer nga Misioni Vëzhgues i OSBE/ODIHR-it për periudhën zyrtare të fushatës zgjedhore (28 maj-26 qershor) tregon më shumë balancë në pasqyrimin sasior të dy partive kryesore politike, sesa përpara fillimit të fushatës zgjedhore. TVSH-ja publike i kushtoi PD-së 45 përqind të kohës në edicione lajmesh dhe programe informative, ndërkohë që PS-së i kushtoi 25 përqind. Në Vizion +, PD-së iu dha 37 përqind e kohës, ndërsa PS-së 28 përqind. TV Klan i kushtoi 56 përqind të kohës së transmetimit PD-së dhe 30 përqind PS-së. News 24 dhe TOP Channel i dhanë pothuajse të njëjtën kohë si PD-së, ashtu edhe PS-së.³⁵ Megjithatë, të dyja këto kanale vazhduan të tregonin preferencë/njëanshmëri me PS-në, kjo për sa i përket tonit të përdorur gjatë transmetimit. Vizion+ tregoi një qasje negative ndaj PD-së, ndërkohë që pjesa më e madhe e pasqyrimin të PD-së dhe PS-së në TVSH dhe TV Klan ishte me ton pozitiv. Transmetuesit e monitoruar nuk iu përmbajtën detyrimeve që rrjedhin nga Kodi Zgjedhor në lidhje me balancimin e pasqyrimin të dy partive “të mëdha” dhe mbështetjen e një mbulimi të baraspeshuar për partitë “më të vogla” parlamentare dhe partitë që nuk ishin në parlament.

³¹ Kodi Zgjedhor i referohet “edicioneve të lajmeve dhe programeve informative” (Neni 80.2), si edhe “programeve normale dhe atyre të veçanta të lajmeve” (Neni 84.1). Kodi parashikon që transmetuesit duhet të pasqyrojnë subjektet zgjedhore dhe fushatën zgjedhore në këto programe.

³² Nenet 80, 81 dhe 84 të Kodit Zgjedhor.

³³ Një Ligj për Lirinë e Shtypit i hartuar në vitin 2004 nuk u miratua nga Kuvendi.

³⁴ Dyzetë e pesë përqind e pasqyrimin të fushatës së PD-së në *Gazetën Shqiptare* ishte me nuanca negative, ndërsa pasqyrimin i PS-së ishte gjithësisht pozitiv (43 përqind) ose negativ (48 përqind). Gazeta *Shqip* i pasqyrooi 43 përqind të lajmeve të PD-së me ton negativ ndërsa lajmet e PS-së ose me tone pozitive (48 përqind), ose neutrale (45 përqind). Gazeta *Panorama* tregoi një qasje pak më të balancuar me pasqyrimin neutral si të PD-së (46 përqind) dhe të PS-së (48 përqind), por me një ngjyrim negativ të 21 përqind të hapësirës së PD-së dhe tone pozitive të 40 përqind të PS-së. Gazeta 55 tregoi njëanshmëri të hapur në favor të PD-së me 88 përqind të hapësirës kushtuar partisë në pushtet me tone pozitive. Gjatë së njëjtës periudhë, 88 përqind e pasqyrimin të lajmeve të PS-së në gazetën 55 ishte me ton negativ. Shifrat në këtë pjesë të raportit i referohen pasqyrimin të aktorëve politikë si kandidatë apo pjesëmarrës në fushatë, duke lënë mënjanë pasqyrimin e këtyre aktorëve në rolet e tyre institucionale.

³⁵ News 24 i kushtoi PD-së 38 përqind të pasqyrimin dhe PS-së 37 përqind, ndërsa TOP Channel i dha PD-së 30 përqind dhe 35 përqind PS-së.

Përpos njëanshmërisë të shfaqur si nga ana sasiore, ashtu edhe nga ajo cilësore, u vu re edhe një mungesë e theksuar e pavarësisë editoriale. Gazetarët e të gjithë mediave të monitoruara i treguan MVZ-së së OSBE/ODIHR-it se pasqyrimi i fushatës ishte kthyer më së shumti në një punë, ku transmetoheshin filmimet dhe komentet e bëra e të dhëna nga vetë partitë politike. Ky kontroll i partive politike mbi politikën editoriale, ndonjëherë madje i kamufluar nën petkun e lirisë dhe të drejtave të drejtorit të programit zgjedhur të ftuarin/ën në program, çoi në mungesën e zërave dhe mendimeve që mund të konsideroheshin si kritike apo të pavolitshme për preferencën politike të një kanali të caktuar televiziv.

X. PJESËMARRJA E GRAVE

Zakonisht gratë nuk janë të përfaqësuara aq sa ç' duhet në politikën shqiptare, edhe pse në periudhën përpara zgjedhjeve çështja e balancës gjinore mori më shumë hov se më parë. Ligji për Barazinë Gjinore në Shoqëri, i miratuar në korrik 2008, përcakton se duhet arritur një minimum prej 30 përqindësh në përfaqësimin e secilës gjini në të gjitha institucionet publike, si në nivelin kombëtar, ashtu edhe në atë vendor. Për herë të parë, ndryshimi i Kodit Zgjedhor çoi në vendosjen e kuotave për listën e kandidatëve dhe anëtarësimin në KZAZ.

Gratë nuk janë të përfaqësuara sa duhet në administratë. Vetëm dy prej shtatë anëtarëve të KQZ-së janë femra. Edhe pse gjatë një faze të vonuar të procesit, përmbushja e plotë e kuotave të gjinisë për KZAZ-të u arrit vetëm më 18 qershor. Në fillim, PS-ja nuk iu përmbajt kërkesës që secila gjini të kishte të paktën 30 përqind të anëtarëve të KZAZ-ve në të gjithë vendin të caktuar nga partitë më të mëdha të mazhorancës parlamentare dhe opozitës. Megjithatë, kandidatët e tyre u pranuan nga KQZ-ja në mënyrë që të arrihej afati ligjor për përcaktimin e KZAZ-ve. Në qendrat e votimit, ku shkuan vëzhguesit e Misionit Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MNVZ), gratë përbënin vetëm 16 përqind të anëtarëve të Komisioneve të Qendrave të Votimit dhe vetëm 14 përqind të Kryetarëve të këtyre Komisioneve ishin gra. Në 41 përqind të qendrave të votimit, Komisionet përbëheshin vetëm nga meshkuj.

Kodi Zgjedhor parashikon që në çdo listë kandidatësh të paktën 30 përqind të jenë nga secila gjini, ose një nga tre kandidatët e parë të jetë i/e secilës gjini. Gjatë këtyre zgjedhjeve, 43 përqind i përmbushën të dyja kriteret. Tre kandidatë u regjistruan pa përmbushur asnjërën prej kriterëve, më saktë listat e Partisë Demokratike Sociale dhe Partia Demokratike e Re Evropiane në Lezhë, dhe lista e Ballit Kombëtar Demokratik në Berat.

Kuotat e reja gjinore e shtuan numrin e grave pjesëmarrëse në Parlament, megjithëse dobësitë në formulimin e dispozitave ligjore patën efekt negativ mbi vetë objektivin. Teorikisht, edhe listat e kandidatëve me 30 përqind gra, në të cilat të gjitha femrat janë të vendosura në fund të listës e në pozicione ndoshta të pafitueshme, mund të kualifikohen si lista që përmbushin kriterin e përqindjes. Për më tepër, ligja nuk përcakton tavan për numrin e kandidatëve që mund të jenë në një listë relative me numrin e përgjithshëm të mandateve në një zonë zgjedhore. Në disa raste, partitë që nuk e përmbushën kriterin e gjinisë, thjesht shtuan gra në pozicione që tejkalonin numrin e mandateve. KQZ-ja vendosi që këto lista i përmbushnin kërkesat gjinore, edhe pse asnjë nga gratë e shtuara nuk mund të zgjidhej dot.

Rezultatet tregojnë se në parlamentin shqiptar u zgjodhën 23 gra në vitin 2009, ndërkohë që në 2005-ën në Kuvend kishte vetëm 10 gra deputete, një rritje nga 7.1 përqind në 16.4 përqind. Vendi që mbanin kandidatet gra në listë influenconte suksesin e tyre. Edhe ose 27.8 përqind e kandidatëve të PD-së ishin femra, ato përfaqësonin vetëm 15 përqind të kandidatëve të zgjedhur (10 nga 68). Ndërkohë që në Partinë Socialiste, gratë ishin më të pakta në numër, por vendosja e

tyre në pozicione më të larta në lista, bëri që 20 përqind e deputetëve të PS-së të ishin femra (13 nga 65).

XI. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE

Kushtetuta u garanton të drejta të plota pakicave kombëtare. Megjithëse nuk ekzistojnë të dhëna të besueshme zyrtare mbi pakicat apo minoritetet në Shqipëri, pranohet gjerësisht që më të mëdhenjtë janë minoritetet greke dhe rome, edhe pse ky i fundit njihet si bashkësi e jo si pakicë kombëtare. Minoritete më të vogla përfshijnë maqedonasit etnikë, bullgarët etnikë, serbët, malazezët, boshnjakët dhe vllahët etnikë. Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNj) kryesisht përfaqëson votuesit grekë. Aleanca Maqedonase për Integrimin Europian (AMIE) është pjesë e koalicionit Aleanca për Ndryshim e udhëhequr nga PD-ja. Lëvizja për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut ka në qendër të vëmendjes minoritetet në përgjithësi, ndërkohë që Partia Toleranca e Re mbron interesat e romëve dhe egjiptianëve. Të dyja këto parti ishin pjesë e Aleancës Socialiste për Integrim. Votuesit zgjodhën një anëtar të minoritetit grek nga PBDNj-ja dhe disa përfaqësues grekë nga listat e PD-së dhe PS-së.

Për komunitetin rom u ngritën një sërë çështjesh në lidhje me zgjedhjet. Për të lehtësuar pajisjen me karta të romëve, më 15 prill Qeveria vendosi që ata kishin mundësinë të aplikonin për të pa pagesë. Zbatimi i këtij veprimi ishte kontradiktor, për arsye se në dokumentet zyrtare romët nuk identifikohen si të tillë. Për pasojë, zbatimi i vendimit nuk ishte gjithmonë i njëjtë. Në shumë zona romët u lejuan të aplikonin falas, ndërkohë që në vende të tjera ata duhet të paguanin çmimin e plotë. Në shumë zona, udhëheqësit e bashkësisë rome dhe OJQ-të ndihmuan autoritetet në identifikimin e romëve. MVZ-së së OSBE/ODIHR-it i erdhën një sërë aludimesh për blerje votash në këtë komunitet, madje edhe nga vetë anëtarët e këtij komuniteti. Dy raste të tilla u vërtetuan në rrethet Lezhë dhe Durrës. Një rast tjetër u vërtetua në Korçë, ku një prej liderëve të komunitetit rom kontrollonte votat e rreth 30 anëtarëve të familjes dhe kushërinjve të tij.

XII. VËZHguesIT VENDAS

Kodi Zgjedhor parashikon që në vëzhgimin e zgjedhjeve marrin pjesë si vëzhgues të huaj, ashtu edhe ata vendas. Sipas Nenit 6 të Kodit Zgjedhor, përveç subjekteve zgjedhore kandidatët e të cilëve janë regjistruar nga KQZ-ja, OJQ-të shqiptare kanë të drejtën të caktojnë vëzhgues në të gjitha KZAZ-të, në çdo qendër votimi dhe në çdo tavolinë numërimi në një Vend të Numërimit të Votave (VNV).

Procesi i akreditimit të vëzhguesve vendas jo-partiakë ishte i hapur dhe transparent. KQZ-ja regjistroi gjithsej 6,120 vëzhgues vendas nga 16 OJQ të ndryshme, duke i dhënë kështu procesit zgjedhor një element më tepër transparence. Përpjekjet më të mëdha për vëzhgimin e zgjedhjeve në nivel vendor u bënë nga një koalicion prej gjashtë OJQ-shë nën udhëheqjen e Shoqërisë për Kulturë Demokratike, e cila kishte 2,300 vëzhgues. Ish kryetari i Lëvizjes *MJAFT!*, një prej OJQ-ve në koalicion, është udhëheqësi i Partisë G99. Kjo bëri që disa nga palët e interesuara të mos kishin besim tek paanshmëria e koalicionit.³⁶

³⁶ Raste të tjera në të cilat aktivistë të njohur të shoqërisë civile konkurruan si kandidatë ishin ato të ish-Shefes së Komitetit Shqiptar të Helsinkit, e cila ishte në krye të listës së PS-së në Tiranë, dhe ish-Drejtorit të Lëvizjes Evropiane në Shqipëri, i cili ishte në numrin 7 të së njëjtës listë.

Në bazë të të dhënave që i dërgoheshin KQZ-së, dy OJQ shqiptare, ECA dhe KRIIK–Albania, kryen llogaritjen paralele të rezultateve në të 66 VNV-të dhe i vendosën ato në faqen e internetit të ECA-s. Nxjerrja e rezultateve nga KQZ-ja dhe këto OJQ çuan në më shumë transparencë në një fazë të rëndësishme të procesit zgjedhor.

Vëzhguesit partiakë ishin të pranishëm në 95 përqind të qendrave të votimit, që u vizituan nga vëzhguesit të MNVZ-së ditën e zgjedhjeve, ndërsa vëzhguesit vendas jo-partiakë gjendeshin në 26 përqind të tyre.

XIII. ANKESAT DHE KËRKESËPADITË GJATË PERIUDHËS PARAZGJEDHORE

Sipas Kodit Zgjedhor, e drejta për ankime dhe kërkesëpadi u jepet vetëm subjekteve zgjedhore. Ndërsa votuesit individualë nuk kanë mundësi ankimimi ligjor në rast të shkeljes së të drejtave të tyre zgjedhore, përveç kërimit të përfshirjes së tyre Listën Përfundimtare të Zgjedhësve. Subjektet zgjedhore mund të ankohen pranë KQZ-së në lidhje me zhvillimin e procesit zgjedhor. KQZ-ja shqyrton edhe ankesat ndaj vendimeve të KZAZ-ve, apo ndaj mosmarrjes së vendimeve nga ana e KZAZ-ve. Të gjitha vendimet e KQZ-së, apo mosmarrja e vendimeve nga KQZ-ja, mund të ankimohen në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit në Tiranë, si instanca e fundit e ankimit.³⁷ Kodi Zgjedhor nuk parashikon një mekanizëm për zgjidhjen e ankesave në nivel KQV-je, edhe pse e detyron Sekretarin/en e KQV-së të mbajë një regjistër për ankesat e depozituara në KQV (Neni 41).

Pavarësisht nga disa aludime për shkelje të rregullave të fushatës, subjektet zgjedhore nuk i përdorën burimet e vëna në dispozicion, kështu që në KQZ nuk u depozitua asnjë ankesë përpara ditës së zgjedhjeve. Në KQZ u bënë tri kërkesa për rishikim vendimi të dy KZAZ-ve në zonën e Shkodrës, ku u refuzohej akreditimit vëzhguesve të Polit të Lirisë dhe Aleancën Socialiste për Integrim. KQZ-ja i trajtoi këto kërkesa në mënyrë të drejtë dhe i dha problemit një zgjidhje efikase.

Para ditës së zgjedhjeve në Kolegjin Zgjedhor u bënë shtatë kërkesa për rishikim të vendimeve të KQZ-së. Ato kishin të bënin me ngritjen e VNV-ve në ndërtesa private, me përcaktimin e partive që kishin të drejtë të merrnin pjesë në shortin për caktimin e anëtarit të tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit, si edhe me miratimin e listave të kandidatëve për Partinë Agrare Ambientaliste. Dy prej kërkesave u hodhën poshtë për arsye procedurale. Kolegji Zgjedhor la në fuqi dy vendime të KQZ-së dhe hodhi poshtë dy, njërin plotësisht, tjetrin pjesërisht. Në përgjithësi, Kolegji Zgjedhor i shqyrtoi kërkesëpaditë e sjella para tij në mënyrë të paanshme, duke u bërë kështu një korigjues i efektshëm dhe i përshtatshëm gjatë periudhës parazgjedhore. Megjithatë, Kolegji nuk arriti t'i përmbahej dispozitës së Kodit Zgjedhor (Neni 158), që e detyron atë të zbardhë vendimet jo më vonë se tri ditë nga data e dhënies së tyre, duke specifikuar provat dhe arsyet mbi të cilat mbështetet në marrjen e atyre vendimeve. Në rast se Kolegji Zgjedhor ia kthen çështjen KQZ-së për shqyrtim, moszbardhja e vendimit ka ndikim negativ në mjetet që mund të përdorë ankimesi për të kërkuar zgjidhje të efektshme dhe në kohë të çështjes.

³⁷ Kolegji Zgjedhor, i cili përbëhet nga tetë gjykatës të zgjedhur me short nga një grup gjykatësish apeli, shqyrton çështjet në panele prej pesë anëtarësh, edhe këta të zgjedhur me short.

XIV. VOTIMI DHE NUMËRIMI

A. DITA E ZGJEDHJEVE

Dita e zgjedhjeve në përgjithësi ishte e qetë, pa incidente të rënda apo dhunë. Sipas KQZ-së, u hapën të gjitha qendrat e votimit përveç pesë prej tyre, dhe pjesëmarrja e zgjedhësve ishte 50.77 përqind. Partitë politike të shumicës qeverisëse dhe opozita e përshëndetën zhvillimin e votimit si një përmirësim të ndjeshëm krahasuar me zgjedhjet e mëparshme. KQZ-ja filloi të shpallë rezultatet në mbrëmjen e zgjedhjeve ndërsa rezultatet merreshin nga VNV-të dhe i vendoste ato në faqen e tij të internetit, deri në nivelin e qendrës së votimit.

Gjatë hapjes së qendrave të votimit, vëzhguesit e MNVZ-së vunë re një numër relativisht të lartë të rasteve ku materiali zgjedhor ishte jo i plotë, si dhe raste kur mungonte boja matrikuluese e përdorur për të shënuar zgjedhësit ose raste ku kutitë e bojës për të vulosur fletët e votimit ishin tharë. Ata raportuan gjithashtu probleme me regjistrimin e numrave të serisë së vulave të kutive të votimit dhe me depozitimimin e Procesverbalit të Vulosjes në kutinë e votimit. Shumë KQV nuk hodhën me shkrim dhe nuk firmosën vendimin formal për hapjen e votimit, siç e kërkonte ligji. Këto probleme çuan në vlerësimin kritik të procesit të hapjes nga shumë vëzhgues të MNVZ-së. Në dy të tretat e qendrave të votimit ku u vëzhgua hapja, qendrat u hapën me vonesë, në shumicën e rasteve me vonesë deri në 30 minuta.

Vëzhgues të MNVZ-së vlerësuan procesin e votimit si të mirë ose shumë të mirë në 92 përqind të qendrave të votimit që u vizituan. Vlerësimi i përgjithshëm ishte më pozitiv në zonat urbane, sesa në ato rurale. Rajonet me një raport relativisht të lartë të vlerësimeve negative përfshinin Vlorën, Durrësin, Kukësin, Dibrën (Peshkopinë) dhe Korçën. Performanca e KQV-ve, si dhe të kuptuarit e procedurave prej tyre u vlerësua pozitivisht në shumicën e qendrave të votimit që u vizituan. Në ato raste kur KQV-të nuk ishin mjaftueshëm në dijeni me procedurat, kjo mund të kenë qenë pjesërisht për shkak të emërimit me vonesë të shumë anëtarëve të KQV-së, të cilët nuk iu nënshtruan trajnimit zyrtar.

Tensionet ishin të dukshme në disa qendrave të votimit ose rreth tyre (përkatësisht 4 dhe 3 përqind), ndonjëherë të shkaktuara nga aktivistë të partive të ndryshme politike. Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan gjithashtu raste të zhvillimit të fushatës ose në qendrat e votimit, ose përreth tyre (përkatësisht 1 dhe 5 përqind).

Vëzhguesit e MNVZ-së konstatuan disa shkelje procedurale. Në veçanti, nuk u ndoqën gjithmonë procedurat e shënimit me bojë, duke zhvlerësuar kështu një masë të rëndësishme sigurie kundër votimit të shumëfishtë të mundshëm: në 29 përqind të qendrave të votimit që u vizituan, jo të gjithë zgjedhësit u kontrolluan nëse ishin shënuar me bojë apo jo, dhe në 10 përqind ata nuk u shënuan gjithnjë me bojë. Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan shtatë raste kur zgjedhësit u lejuan të votonin, edhe pse kishin shenja boje. Votimi i shumëfishtë përbën një sfidë të drejtpërdrejtë për parimin universal të barazisë së votës të përfshirë në paragrafin 7.3 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së.

Në 9 përqind të qendrave të vizituara, nuk u garantua fshehtësia e votës e parashikuar në paragrafin 7.4 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së, kryesisht për shkak të mosplanifikimit të mirë të hapësirës, kufizimeve të kësaj hapësire, apo numrit të madh të njerëzve. Megjithatë, në 2 përqind të qendrave të votimit që u vizituan, jo të gjithë zgjedhësit shënuan fletën e votimit brenda në kabinë dhe në 4 përqind të qendrave të vizituara jo të gjithë zgjedhësit palosën fletën e tyre të shënuar në mënyrë që të siguronte fshehtësinë e votës. Votimi

familjar, një shkelje e fshehtësisë së votës, u raportua nga 19 përqind e qendrave të votimit që u vizituan.

Probleme të tjera që u konstatuan ishin: votimi në emër të personave të tjerë (3 përqind), përpjekje për të influencuar tek zgjedhësit (4 përqind), raste kur i njëjti person “ndihmon” më shumë se një zgjedhës (4 përqind), presion mbi zyrtarë të zgjedhjeve ose zgjedhës (1 përqind) si edhe firma të ngjashme në listën e zgjedhësve (4 përqind). Në disa raste të izoluara, lista e zgjedhësve nuk ishte e plotë, duke privuar kështu disa zgjedhës nga e drejta për të votuar. Me shumë pak përjashtime, kutitë e votimit ishin vulosur siç duhej, por në 14 përqind të qendrave të votimit që u vizituan, numri i serisë i vulës së sigurisë nuk ishte regjistruar në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Në 3 përqind të qendrave të votimit që u vizituan, u vunë re persona të paautorizuar që ndërhyjnë ose drejtonin procesin në nëntë raste.

Gjatë ditës së zgjedhjeve, pasi zbuloi që disa komisionerë dhe aktivistë të PS-së në Tiranë dhe në qytete të tjera mbanin mikro-kamera të fshehura në stilolapsa dhe llamba UV, për t'i përdorur me sa dukej për të zbuluar karta të falsifikuara identiteti, KQZ-ja bëri një deklaratë duke u shprehur që përdorimi i mikro-kamerave dhe llambave fluroshente brenda qendrave të votimit ishte i paligjshëm dhe do bëhej objekt ndjekjeje penale.

Procedurat e mbylljes u vlerësuan përgjithësisht me nota pozitive nga shumica e vëzhguesve të MNVZ-së, por disa konstatuan që procesi ishte i ngadaltë për shkak të mungesës së trajnimit. Ata raportuan gjithashtu probleme procedurale, si: mosvulosja e të kutisë së votimit pas përfundimit të votimit, ose mosregjistrimi i numrit të serisë të vulës së sigurisë; raste të izoluara të KQV-ve që nuk numëronin ose nuk regjistronin numrin e zgjedhësve që votuan, numrin e fletëve të papërdorura të votimit, ose numrin e fletëve të votimit të prishura; dhe raste të shpeshta kur vëzhguesve të partive nuk u jepej kopje e Procesverbalit të Mbylljes.

Pas mbylljes së votimit, kutitë e votimit dhe kutitë me materialin zgjedhor u transportuan nga KQV-të në 66 VNV. Marrja e materialit zgjedhor në VNV u vlerësua përgjithësisht pozitivisht, edhe pse numri i KQV-ve që prisnin për t'u marrë në shqyrtim në disa VNV, çoi në mbipopullim në këto vende, sidomos në zonat urbane me shumë qendra votimi. Përgjithësisht, për marrjen e materialit zgjedhor u ndoqën procedurat e parashikuara. Megjithatë, vëzhguesit e MNVZ-së konstatuan që në disa VNV, vëzhguesit vendas partiakë apo jopartiakë nuk u lejuan që të vëzhgonin.

B. NUMËRIMI I VOTAVE

Numërimi i votave në 66 VNV-të filloi pasi KQV-të e Zonës përkatëse të Administrimit Zgjedhor (ZAZ) kishin dorëzuar të gjitha kutitë e tyre të votimit dhe kutitë e materialeve të tjera zgjedhore. Procedurat në të gjitha VNV-të u transmetuan direkt në KQZ, ku mund të monitoroheshin në ekrane të mëdhenj. Gjithashtu, kanalet kryesore televizive siguruan pasqyrim të madh të procesit të numërimit. Çdo VNV kishte pesë deri në dhjetë tavolina numërimi me dy Grupe të Numërimit të Votave (GNV) për çdo tavolinë, të cilët punonin në turne. Për të siguruar ekuilibër politik, GNV-të përbëheshin nga katër anëtarë, të caktuar nga shumica parlamentare dhe nga opozita. Një GNV supozohej të numëronte nga pesë deri në dhjetë kuti votimi përpara se të përfundonte, por shpesh ato nuk zëvendësoheshin, duke u sforcuar kështu akoma më tepër.

Vëzhguesit e Misionit Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MNVZ) ndoqën numërimin e votave në të gjitha VNV-të nga mbrëmja e 28 qershorit dhe në pothuajse të gjitha VNV-të deri në përfundim të tij, duke raportuar për situatën në intervale të rregullta kohore. Asnjë KZAZ nuk arriti të përfundonte numërimin e votave për ZAZ-në e saj në afatin ligjor, në orën 17:00 më 29 qershor. Vëzhguesit e MNVZ-së vlerësuan negativisht numërimin e votave në 22 nga 66 VNV.

Nga KZAZ-të në këto VNV, 12 kishin shumicën e anëtarëve të caktuar nga opozita dhe 10 kishin shumicën e anëtarëve të caktuar nga partitë qeverisëse. Transparenca e procesit të numërimit u vlerësua negativisht në 11 VNV. Vëzhguesit vendas partiakë dhe jopartiakë u penguan të vëzhgonin procesin në përkatësisht 18 dhe 17 VNV.

Vëzhguesit e MNVZ-së vunë re probleme procedurale, disa prej të cilave u shfaqën për shkak të pamjaftueshmërisë së trajnimit dhe udhëzimit. Respektimi i procedurave të numërimit ishte i pamjaftueshëm në 9 VNV (14%). Anëtarët e GNV-ve përgjithësisht e kuptonin mirë procesin, por në 14 VNV (21%) ata nuk vepruan si duhej. Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan që në 62 VNV (94%), një ose më shumë GNV kishin probleme me përfundimin e tabelës së rezultateve për qendrat e votimit.

Mangësi të tjera gjatë numërimit të votave përfshinë: mosverifikimin e të gjithë materialit zgjedhor përpara hapjes së kutive të votimit (ndërmjet 8 dhe 17 VNV, sipas hapave specifike të verifikimit); mosekspozimi i faqes së prapme të çdo flete votimi tek kamera e monitorimit (30 VNV); mosekspozimi i faqes së përparme të çdo flete votimi tek kamera e monitorimit (8 VNV); raste të përcaktimit të paarsyeshëm ose të papajtueshëm të vlefshmërisë së fletëve të votimit (34 VNV); raste kur vëzhgues të partive nuk janë lejuar të kundërshtojnë fletët e votimit (28 VNV); mosshënimi i arsyes për të kundërshtuar një fletë votimi në faqen e prapme të fletës së votimit (35 VNV). Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan gjithashtu që kopjet e tabelës së rezultateve të qendrës së votimit nuk u jepeshin gjithmonë anëtarëve të GNV-së dhe/ose vëzhguesve partiakë (u raportuan nga 23 dhe 30 VNV përkatësisht) në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Nisur nga rezultatet e pjeshme paraprake që sugjerorin një garë të ngushtë, partitë politike filluan të ndërhyjnë në procesin e numërimit. Si rezultat, procesi u bllokua në disa VNV, sidomos në qarqe ku ndarja e mandateve ishte ose dukej shumë e ngushtë. Disa KZAZ kishin probleme për të kontrolluar procesin në VNV. Vëzhguesit e MNVZ-së panë vëzhguesit e partive që ushtronin presion mbi anëtarët e KZAZ-ve dhe GNV-ve që dhe ndërhyjnë në numërim. Ata gjithashtu vunë re brenda VNV-së praninë e kandidatëve shpesh të tërhequr nga procesi. Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan ndërhyrje nga përfaqësuesit e partive në 28 VNV. Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan praninë e personave të paautorizuar në 49 VNV dhe këta persona ndërhyjnë ose drejtonin procesin në 21 prej tyre. Vëzhguesit e MNVZ-së vunë re tension ose trazira në 45 VNV.

Një nga problemet kryesore të vëna re gjatë numërimit të votave ishin diskutimet nëse duheshin numëruar apo jo disa kuti votimi. Kodi Zgjedhor parashikon procedurat që duhen ndjekur nga KZAZ-ja për ta shpallur “të parregullt” një kuti votimi vetëm pas marrjes nga KQV-ja nëse është e dëmtuar apo nëse mund të jetë dëmtuar.³⁸ KZAZ-ja duhet të marrë një vendim edhe nëse vihen re pasaktësi apo parregullsi gjatë verifikimit të materialit zgjedhor ose numërimit të votave. Pas shënimit të pasaktësisë apo parregullsisë në Procesverbalin e Konstatimit të KZAZ-së, KZAZ-ja merr “vendim për GNV-në që të vazhdojë procedurat e numërimit të votave” (Neni 116.6 i Kodit Zgjedhor). Në Kod nuk ka dispozita që KZAZ-ja ose GNV-ja të shpallin një kuti votimi të parregullt ose të pavlefshme pas fillimit të numërimit të kutisë nga GNV-ja.

Megjithatë, në praktikë Neni 116.6 u interpretua duke i dhënë KZAZ-së autoritet për të ndaluar numërimin e një kutie votimi ose për të mos e përfshirë atë në Tabelën e Përmbledhjes së Rezultatit (TPR) për ZAZ-në. Për shembull, gjashtë kuti votimi në ZAZ-në 39 (Laç, Qarku

³⁸ Sipas informacionit të KQZ-së, dy kuti votimi u deklaruan të parregullta në ZAZ-në 13 (Qarku Elbasan) dhe në ZAZ-në 38 (Qarku Lezhë).

Lezhë) nuk u numëruan për shkak të mungesës së numrave të dokumentit të identitetit në listën e zgjedhësve.³⁹ KZAZ-ja nuk e plotësoi dhe as nuk mori vendim për TPR-në.

Raste të tjera të mosnumërimit të të gjitha kutive të votimit kishin të bënin vetëm me dy qendra votimi në ZAZ-në 11 (Krujë, Qarku Durrës), shtatë në Qarkun Korçë (ZAZ-të 29, 30, 31 dhe 32) dhe një në Berat (ZAZ-ja 2). Megjithatë në këto raste, KZAZ-ja përfundoi TPR-në dhe ia dërgoi atë KQZ-së. Në ZAZ-në 30 në Qarkun Korçë, Kryetari i KZAZ-së nuk i dërgoi rezultatet nga pesë qendra të votimit në KZA, deri në momentin që u pyet nga vëzhguesit e MNVZ-së për arsyet e mosdërgimit të tyre. Po ky kryetar vendosi, po ashtu, të mos numërojë kutinë e fundit, duke thënë që rezultati në ZAZ ishte “tepër i ngushtë” që ta merrte ai përgjegjësinë e numërimit të tij. Në ZAZ-në 37 (qyteti Lezhë), KZAZ-ja me shumicë të PS-së vendosi të mos përfshijë rezultatet nga 11 qendra votimi në TPR. Anëtarët e KZAZ-së së caktuar nga partitë qeverisëse dërguan një TPR që përfshinte të gjitha qendrat e votimit në ZAZ, por nuk ishte firmosur nga shumica e anëtarëve të KZAZ-së.

Në VNV-në 41 në Bushat (qarku Shkodër), shumica e anëtarëve të KZAZ-së të emëruar nga opozita bllokuan procesin dhe nuk numëruan asnjë fletë votimi nga ora 14:00 më 30 qershor deri në 12:00 më 1 korrik. Gjatë kësaj periudhe, kryetari i KZAZ-së, i cili ishte i emëruar nga PS-ja, u zëvendësua dy herë, me marrëveshje me anëtarët e KQZ-së të emëruar nga opozita dhe përfaqësuesit të PS-së në KQZ. Numërimi vazhdoi dhe përfundoi pa probleme, vetëm pasi u bë e dukshme që 42 kutitë e panumëruara nga Bushati nuk do të ndikonin në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore. Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan se rastet e mungesës së numrave të dokumenteve të identifikimit në listën e zgjedhësve, gjë e cila kishte qenë edhe arsyeja kryesore që ishte dhënë më parë për refuzimin e numërimit të këtyre kutive të votimit, nuk u konsiderua më problem.

Probleme më të rënda në lidhje me numërimin e votave u vunë re në qarkun e Fierit. Përveç tri qendrave të votimit që nuk u hapën ditën e zgjedhjeve, rezultatet nga nëntë qendra votimi nuk u përfshinë në TPR. Votat nga pesë prej tyre në fakt u numëruan, por shumica e anëtarëve të KZAZ-ve 18 dhe 20 refuzuan t'i përfshinin ato në TPR. Në ZAZ-në 20, politikanë të njohur dhe mbështetës të PS-së u mblodhën jashtë VNV-së duke kërkuar që kutitë e kontestuara të votimit të përfshiheshin në tabelën e rezultateve dhe duke i bërë presion KZAZ-së. Pas disa orësh, situata e tensionuar u zgjidh dhe turma u shpërnda. Kjo bllokadë vijoi me arrestimin e katër protestuesve, tre prej të cilëve u liruan menjëherë. Arsyet kryesore për problemet e vëzhguara në Fier ishte rezultati i ngushtë i zgjedhjeve, ku një mandat ndante ekuilibrin ndërmjet koalicionit të udhëhequr nga PD-ja dhe atij të udhëhequr nga PS-ja.

Fatkeqësisht, kur u vunë re apo kur u raportuan probleme në VNV, KQZ-ja shpesh zgjodhi të mos ndërhynte me vendosmërinë e duhur, pavarësisht faktit se ndodhej në një pozitë të tillë, ku mund të monitoronte çfarë ndodhte në VNV. Edhe pse KQZ-ja dërgoi inspektorë në disa VNV problematike, kjo shpesh ishte e pamjaftueshme për të zgjidhur problemet. Udhëzimet e pamjaftueshme për KZAZ-të dhe GNV-të, si edhe mungesa e veprimit ku ndodhnin probleme, çuan në debate të vazhdueshme në KQZ në lidhje me çështjen se kur dhe si duheshin trajtuar këto probleme, sidomos kur bëhej fjalë për kuti të panumëruara votimi.

Mënyra se si u zbatua sistemi i ri i monitorimit, me anë të të cilit çdo fletë votimi vihej nën kamera dhe u tregohej vëzhguesve në ekrane të mëdha disa metra lart nga tavolinat e numërimit, duket se ka kontribuar vetëm pjesërisht në transparencën e procesit, por nuk zgjidhi problemet e

³⁹ Sipas Kodit Zgjedhor, në kohën kur i jepej fleta e votimit zgjedhësit, kryetari i KQV-së duhej të shkruante në listën e zgjedhësve numrin e dokumentit të identifikimit të çdo zgjedhësi. Në disa qendra votimi, nuk u ndoq fare kjo procedurë; në raste të tjera, mungonin disa numra të dokumenteve të identifikimit.

ndërhyrjes të vëna re si në këto zgjedhje, ashtu edhe në zgjedhje të mëparshme. Ndërsa fletët e votimit mund të shiheshin në ekrane, zgjedhja e votuesit nuk ishte gjithmonë e dallueshme dhe shpesh ishte e pamundur për vëzhguesit që të shikonin nëse fletët e votimit vihejshin në grumbullin e duhur; partitë e vogla pretenduan që votat e tyre ishin vënë në grumbullin e dy partive kryesore.

XV. MBLEDHJA DHE SHPALLJA E REZULTATEVE NGA KQZ-JA

Meqenëse Kodi Zgjedhor nuk parashikon rregulla specifike në lidhje me publikimin e rezultateve paraprake, KQZ-ja miratoi udhëzime për transmetimin elektronik të rezultateve të zgjedhjeve nga VNV-të në KQZ, si dhe publikimin e tyre. Sapo të ishte bërë numërimi, KZAZ-të ishin të detyruara të dërgonin në mënyrë elektronike një tabelë rezultatesh për çdo qendër votimi. Këto rezultate shpallejshin në faqen e internetit të KQZ-së. Rezultatet e pjesshme paraprake të mbledhura shfaqeshin gjithashtu direkt në KQZ. Shpallja e vazhdueshme dhe në kohë e rezultateve paraprake nga KQZ-ja rriti transparencën e procesit dhe ishte një burim i besueshëm informacioni. Megjithatë, KQZ-ja nuk përfshiu disa të dhëna kryesore, si numri i zgjedhësve të regjistruar, numri i zgjedhësve që kishin votuar dhe numri i fletëve të pavlefshme të votimit.

KQZ-ja përmbledhi rezultatet për të 12 zonat zgjedhore, bazuar në Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve (TPR) që dorëzohej nga KZAZ-të. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i miratoi të gjitha TPR-të me shumicë të thjeshtë prej 4 votash. Rezultatet e përpiluara nga KQZ-ja nuk përfshinin rezultatet e 33 qendrave të votimit; pesë nga këto qendra votimi nuk u hapën ditën e zgjedhjeve, ndërsa fletët e votimit të 28 qendrave të votimit ose nuk ishin numëruar fare, ose rezultatet e tyre nuk ishin përfshirë në TPR-në për çdo ZAZ përkatëse. Pavarësisht kërkesës ligjore sipas së cilës një KZAZ duhet të përfshijë rezultatet për çdo qendër votimi dhe çdo subjekt zgjedhor në tabelën e rezultateve të ZAZ-së së tij, KQZ pranoi TPR të mangëta nga disa KZAZ me argumentin që ato ishin firmosur nga të gjithë anëtarët e KZAZ-së, ose nga shumica e kërkuar.

TPR-të që nuk përmbanin rezultatet e të gjitha qendrave të votimit shpesh kundërshtoheshin nga partitë dhe ishin shkak për ankime paszgjedhore që dorëzoheshin në KQZ. Rasti më i dukshëm kishte të bënte me qarkun e Fierit, ku KQZ-ja kishte miratuar tabelën e rezultateve pa rezultatet nga nëntë qendra votimi që ose nuk ishin numëruar, ose ishin shpallur të pavlefshme nga KZAZ-ja përkatëse. Pas procesit të ankimit, në TPR u përfshinë rezultatet e këtyre qendrave të votimit, të cilat çuan në fitoren e një mandati të PS-së në dëm të koalicionit të PD-së. Si rezultat i procesit të ankimit, KQZ-ja përfshiu në tabelën e rezultateve për qarkun e Lezhës edhe rezultatet e 11 qendrave të votimit që KZAZ-ja 37 kishte refuzuar t'i përfshinte në TPR-në e saj, edhe pse ato ishin numëruar. Ndryshe nga Fieri, kjo nuk pati ndikim në ndarjen e mandateve.

KQZ-ja nuk përdori kompetencën ligjore për të kryer hetime me nismën e vet, në rastet kur jo të gjitha rezultatet e qendrës së votimit ishin përfshirë në tabelën e rezultateve. Përkundrazi, KQZ-ja thjesht zbardhi rezultatet nga tabela e rezultateve fillestare të qendrës së votimit në TPR-në përfundimtare.

Pas procesit të ankimit në KQZ, tri ndryshimet në TPR-në për qarqet Fier, Lezhë dhe Shkodër që rezultuan nga procesi i ankimit, kaluan me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm të KQZ-së.⁴⁰

⁴⁰ Përfshirja e rezultateve nga një qendër votimi në TPR për qarkun e Shkodrës dështoi, pasi KQZ-ja nuk mblodhi dot shumicën prej pesë votash për ta mbajtur në fuqi apelimin.

Edhe vendimet për ndarjen e mandateve për 12 zona zgjedhore, u kaluan me unanimitet. E njëjta gjë ndodhi edhe me deklaratën e KQZ-së për rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve më 1 gusht.

XVI. ANKESAT NË LIDHJE ME DITËN E ZGJEDHJEVE

A. GJYKIMI I ANKESAVE PASZGJEDHORE NGA KQZ-JA

Kodi Zgjedhor parashikon që subjektet zgjedhore të ankimojnë një tabelë rezultatesh të përgatitur nga një KZAZ si dhe çdo vendim të ndërmjetëm të marrë nga KZAZ-ja gjatë marrjes së materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultateve zgjedhore, së bashku me vendimin e KQZ-së që ka aprovuar Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit (TRP). Këto ankesa mund të depozitohen brenda tri ditëve të vendimit përkatës të KQZ-së. Të gjitha 34 ankimet paszgjedhore të depozituara në KQZ ishin kundër vendimeve të KQZ-së që miratonin tabelat e rezultateve në qarqe të ndryshme. Duhet vënë në dukje që numri i ankesave që u paraqitën në KQZ pas ditës së zgjedhjeve ishte shumë i reduktuar në krahasim me zgjedhjet e mëparshme.⁴¹ Arsyeja për këtë mund të jetë pjesërisht reduktimi i zonave zgjedhore nga 100 në 12.

KQZ-ja kishte dhjetë ditë kohë për të vendosur për këto ankesa; vendimi i KQZ-së mund të ankimohej më tej në Kolegjin Zgjedhor brenda pesë ditëve. KQZ-ja nuk e përdori asnjëherë afatin kohor të vendosur nga Kodi Zgjedhor duke vendosur brenda një dite për shumicën e ankesave paszgjedhore. Të vetmet përjashtime ishin ankimet kundër tabelave të rezultatit të zonave zgjedhore të Lezhës dhe Fierit, ku KQZ-ja bëri rinumërim votash. Në gjykimin e ankesave kundër Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit, KQZ-ja nuk kërkoi asnjëherë informacion apo prova shtesë nga ato që u paraqitën nga paditësi. Po kështu, KQZ-ja nuk thirri asnjëherë në cilësinë e dëshmitarit ndnjë anëtar të KQV-ve, KZAZ-ve ose të grupit të numërimit të votave (GNV). Përkundrazi, KQZ e bazoi hetimin në dokumente të administrimit të zgjedhjeve, kryesisht në Procesverbalin e Konstatimit të KZAZ-së, Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së ose KQV-së dhe në tabelat e rezultateve të qendrave të votimit që përmbanin shënime nga anëtarë të grupit të numërimit.

Gjatë procesit të ankimit, KQZ-ja numëroi fletëvotimet e gjashtë qendrave të votimit në qarkun e Lezhës (ZAZ 39), tetë qendrave të votimit në qarkun Fier dhe dy qendrave të votimit në qarkun Shkodër. Përveç rezultateve nga një qendër votimi në qarkun e Shkodrës, që u shpallën të pavlefshme, rezultatet nga këto qendra votimi u përfshinë në Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit përkatës. Po ashtu, KQZ-ja vendosi të përfshijë rezultatet e dy qendrave të votimit në qarkun Fier dhe 11 qendrave të votimit në qarkun Lezhë, që ishin numëruar, por nuk ishin përfshirë nga KZAZ-të në tabelat përkatëse të rezultateve. Pas procesit të ankimit në KQZ, rezultatet nga 28 qendra votimi gjithsej iu shtuan rezultateve të shpallura.

Sipas Kodit Zgjedhor, subjektet zgjedhore mund të kërkojnë pavlefshmërinë e rezultateve në një ose më shumë qendra votimi, nëse është shkelur ligji, qendra e votimit nuk është hapur, ose votimi është pezulluar për më shumë se gjashtë orë ditën e zgjedhjeve dhe nëse ndonjë nga këto shkaqe mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve. Partia për Drejtësi dhe Integritim (PDI, pjesë e koalicionit të PD-së) kërkoi pavlefshmërinë e rezultateve në katër qendra votimi në zonën zgjedhore të Fierit. PS-ja argumentoi që ankesa duhej hedhur poshtë meqenëse kishte kaluar afati

⁴¹ Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2005, KQZ-ja mori 281 ankesa kundër rezultateve të shpallura nga Komisionet e Zonës Zgjedhore dhe 107 kërkesa për të shpallur të pavlefshëm rezultatit e zgjedhjeve. Nga këto, 185 ankesa dhe 100 kërkesa për pavlefshmëri u gjykuan nga KQZ-ja, ndërsa pjesa që mbeti u refuzuan për arsye procedurale. Në zgjedhjet vendore të vitit 2007, KQZ-ja mori 152 ankesa kundër shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve (ose mosshpalljes së tij) dhe 93 kërkesa për pavlefshmëri.

për paraqitjen e saj dhe KQZ-ja i kishte vlerësuar tashmë fletët e votimit nga këto qendra votimi gjatë një ankimi të mëparshëm për Fierin. Kërkesa për të shpallur të pavlefshëm rezultatin e këtyre dy qendrave të votimit nuk arriti të mernte votat e kërkuara të pesë anëtarëve të KQZ-së.

Gjatë procesit të ankimeve paszgjedhore, ndarjet politike brenda KQZ-së u bënë edhe më të dukshme sesa në periudhën parazgjedhore. Anëtarë të KQZ-së dhe përfaqësues të partive bënë deklarata të shumta politike dhe vërejtje të panevojshme të gjata dhe personale, në vend që t'u referoheshin aspekteve faktike dhe procedurale. Pati raste kur përfaqësues të partive përdorën argumente dhe interpretime ligjore diametrikisht të kundërta të të njëjtave nene të ligjit, kur u binte atyre më mirë për shtat. Për shembull, PD-ja në ankimin e saj kundër tabelës së rezultateve për zonën zgjedhore të Lezhës iu referua nenit 122.2 të Kodit Zgjedhor që kërkon që tabela e rezultateve të plotësohet “për çdo subjekt zgjedhor dhe çdo qendër votimi”, por refuzoi të njëjtin interpretim të nenit kur u përdor nga PS-ja për të kërkuar numërimin e fletëve të votimit të panumëruara në qendra të ndryshme votimi në qarkun e Fierit.

Interpretimi i asaj që konsiderohej një fletë votimi e vlefshme, nxiti debate në KQZ. Sipas nenit 117.3 të Kodit Zgjedhor, një fletë votimi është e pavlefshme nëse “nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja”. Gjatë dëgjimit të ankesave kundër Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Fierit, përfaqësues të PD-së argumentuan se fletët e votimit të cilave iu ishte fshirë boja poshtë vijave ndarëse të kundër-fletëve, duhej të konsideroheshin të pavlefshme pasi ishin me “madhësi tjetër”. Po kështu, disa anëtarë të KQZ-së të caktuar nga opozita argumentuan gjatë numërimit të fletëve të votimit të qendrave të votimit në zonën zgjedhore të Lezhës që nuk ishin numëruar në VNV, se fletët e votimit që u ishte fshirë boja së bashku me kundër-fletët duhej të ishin të pavlefshme pasi ishte cenuar fshehtësia e votës (meqenëse numrat serialë në kundër-fletë mund të lidheshin mundësisht me zgjedhës të veçantë). Nëse pranoheshin, këto interpretime të ligjit, jo vetëm që do të privonin zgjedhësit nga e drejta e votës, por mund të hapnin rrugën që fletët e votimit të griseshin në mënyrë të gabuar me qëllim që të shpallehin qëllimisht të pavlefshme fletët e votimit të disa zgjedhësve.

Duke pretenduar për parregullsi në mbarë vendin, PS-ja depozitoi ankesa në KQZ në lidhje me vendimet e KQZ-së për Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për qarqet e Tiranës, Beratit dhe Shkodrës dhe kërkoi një rinumërim të plotë të fletëve të votimit të numëruara në disa VNV. Përfaqësues të PD-së argumentuan që PS-ja nuk kishte bërë vërejtje të logjikshme për keqmenaxhim apo parregullsi gjatë votimit dhe procesit të numërimit dhe nuk kishte paraqitur prova faktike në mbështetje të pretendimeve të saj. Bazuar në nenin 138.3 të Kodit Zgjedhor që thotë se “në rast se kërkesa për rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave të caktuara bëhet nga dy anëtarë të KQZ-së, ajo është e detyruar të bëjë rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave të kërkuara”, dy anëtarët e KQZ-së të caktuar nga PS-ja kërkuan një rinumërim të plotë të fletëve të diskutuara të votimit. Kryetari i KQZ-së u shpreh se kjo dispozitë u parashikua si mënyrë për të siguruar prova dhe kështu ishte e zbatueshme vetëm për numërimin e “votave të caktuara” dhe jo të gjitha fletëve të votimit që viheshin në diskutim. Avokatët e PS-së e kundërshtuan fuqishëm këtë interpretim duke argumentuar që dispozita ishte masë mbrojtëse për përfaqësues të pakicave në KQZ dhe që kërkesa duhej të ekzekutohej pa miratim formal nga KQZ-ja. Kur u hodhën për votim, kërkesat u refuzuan me votat e katër anëtarëve të KQZ-së të caktuar nga shumica. PS-ja i ankimoi këto vendime të KQZ-së në Kolegjin Zgjedhor.

Tetë ankesa u depozituan në KQZ nga partitë e vogla dhe kandidatë të pavarur që kandiduan në zonën zgjedhore të Tiranës. Paditësit pretenduan që anëtarët e GNV-së nga partitë e mëdha i kishin vendosur qëllimisht votat e hedhura për partitë e vogla në grumbullin e votave të hedhura për partitë e mëdha. Fakti që shumë parti të vogla nuk kishin anëtarë në GNV dhe e drejta për të caktuar vëzhgues u takonte koalicionëve dhe jo partive të veçanta, ishte në disavantazh të këtyre

partive. Monitorimi me kamera i votave ishte jo aq i dobishëm sa parashikohej. Megjithatë, paditësit nuk arritën të paraqisnin prova në mbështetje të akuzave të tyre.

Disa probleme që u vunë re gjatë periudhës paszgjedhore, u vunë re edhe në zgjedhjet e mëparshme, duke treguar që janë pjesërisht sistematike dhe të shkaktuara nga mekanizmi i emërimit politik të administratës zgjedhore. Disa dispozita të paqarta ligjore të trashëguara nga variante të mëparshme të Kodit Zgjedhor çuan në interpretim të papajtueshëm të Kodit. Këto probleme janë thelluar nga mungesa e vullnetit politik të partive politike për të mbajtur gjithmonë në vëmendje kryesore ligjin, qëllimin dhe çdo detaj të tij. Një nga arsyet kryesore për ankimimet paszgjedhore ishin faktorët strategjikë të partive politike që u bënë presion KZAZ-ve ose GNV-ve për të mos numëruar votat.

B. GJYKIMI I ANKESAVE PASZGJEDHORE NGA KOLEGJI ZGJEDHOR

Pesë vendime të KQZ-së që miratojnë Tabelat Përmbledhëse të Rezultatit për zonat zgjedhore të Beratit, Durrësit, Fierit, Shkodrës dhe Tiranës u kundërshtuan në Kolegjin Zgjedhor në 12 ankesa të depozituara nga PS, PD, G99, PDI, Partia Demokristiane, Partia Konservatore dhe Lëvizja për Zhvillim Kombëtar. Si pjesë të ankesës së tyre, PD-ja dhe PDI-ja kërkuan pavlefshmërinë e zgjedhjeve në gjashtë qendra votimi në qarkun e Fierit.

Kolegji Zgjedhor pranoi vetëm një ankesë, të depozituar nga PS-ja kundër vendimit të KQZ-së që miratonte Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të qarkut Fier. PS-ja kishte kërkuar pavlefshmërinë e 440 fletëve të votimit të qendrës së votimit 3052 vetëm me një vulë në pjesën e pasme të fletës së votimit që KQZ e kishte konsideruar të vlefshme për shkak të rrethanave që kishin çuar në këtë parregullsi. Kolegji Zgjedhor pranoi që fletët e votimit nuk kishin në pjesën e pasme të fletëve vulat e KQV-së dhe kryetarit të KQV-së, duhet të konsideroheshin të pavlefshme pavarësisht fakteve që çuan në këtë situatë, për sa kohë që KQZ-ja nuk merrte masat e nevojshme për të ndrequr këtë situatë të parregullt.

Gjatë kundërshtimit të Tabelave Përmbledhëse të Rezultateve në Berat, Tiranë dhe Shkodër, ankimuesit dhe sidomos PS-ja argumentuan që vendimet e KQZ-së ishin të pavlefshme sepse KQZ-ja kishte shkelur nenin 138.3 të Kodit Zgjedhor, kur refuzoi kërkesat për rinumërim nga dy anëtarë të KQZ-së. Kolegji Zgjedhor ndoqi një mënyrë disi formale dhe e interpretoi me kufizime Kodin. Me argumente ndonjëherë kundërshtuese, ai vendosi që termi “vota të caktuara”, që mund të duhet të rinumërohen, do të thotë vetëm fletë votimi që janë kundërshtuar më parë dhe prandaj vetëm këto vota mund të pranohen si provë gjatë hetimit administrativ në KQZ. Kolegji Zgjedhor vendosi gjithashtu që KQZ-ja kishte të drejtë të vendoste nëse një kërkesë e dy prej anëtarëve të saj ishte e justifikuar apo jo, por nuk ishte e detyruar të vepronte sipas kërkesës.

PD-ja kërkoi pavlefshmërinë e zgjedhjeve në tri qendra votimi në qarkun e Fierit, meqenëse një kërkesë paraprake nga PDI-ja në KQZ nuk arriti të merrte numrin e kërkuar të votave. PD-ja dhe PDI-ja i kërkuan gjithashtu Kolegjit Zgjedhor të shpallte të pavlefshme zgjedhjet në tri qendra votimi në qarkun e Fierit të cilat nuk u hapën ditën e zgjedhjeve, siç e përcakton Kodi. Një projekt vendim i përgatitur nga KQZ-ja me nismë e vet për pavlefshmërinë e këtyre qendrave të votimit nuk mori numrin e kërkuar prej pesë votash. Gjatë seancës, ankimuesit pretenduan për shkelje të ligjit, por nuk arritën të përcaktonin ndikimin në ndarjen e mandateve. Kolegji Zgjedhor i hodhi poshtë ankesat.

Seancat në Kolegjin Zgjedhor u zhvilluan në mënyrë profesionale, duke siguruar një proces me kundërshtime dhe duke u dhënë palëve mundësi të barabarta për të paraqitur pretendimet dhe argumentet e tyre. Megjithatë, procesi i vendimmarrjes u paraqit disi i përsheptuar, pasi Kolegji

i mori vendimet ditën e seancave, pasi kishte shqyrtuar qindra faqe me prova në një kohë të shkurtër. Kolegji Zgjedhor nuk përmbushi detyrimin ligjor për të dhënë vendimet e zbardhura me arsyetimin, përfshirë edhe mendimin e pakicës, brenda tri ditëve nga dita e marrjes së vendimit.

XVII. REKOMANDIME

Rekomandimet e mëposhtme jepen për t'u pasur parasysh nga autoritetet, partitë politike dhe shoqëria civile e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të mëtejshme të përpjekjeve të tyre për të zhvilluar zgjedhje në përputhje të plotë me angazhimet e OSBE-së dhe standarde të tjera për zgjedhje demokratike. Disa nga këto rekomandime janë dhënë tashmë në raporte përfundimtare të mëparshme të OSBE/ODIHR-it, por mbeten ende për t'u trajtuar. Rekomandime të tjera të dhëna në raporte përfundimtare të OSBE/ODIHR-it dhe në Opinione të Përbashkëta të Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës dhe OSBE/ODIHR-it mbeten gjithashtu të vlefshme. OSBE/ODIHR-i është i gatshëm të ndihmojë autoritetet dhe shoqërinë civile të Republikës së Shqipërisë për të përmirësuar më tej procesin zgjedhor.

A. PARTITË POLITIKE

1. Partitë politike duhet të tregojnë vullnet politik për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike duke filluar që i korrespondon privilegjeve të mëdha që gëzojnë sipas ligjit në lidhje me zhvillimin e zgjedhjeve. Ato duhet të realizojnë detyrat e tyre zgjedhore në mënyrë të përgjegjshme në interesin e përgjithshëm të Shqipërisë. Kjo vlen edhe për performancën e komisionerëve zgjedhorë dhe nëpunësve të zgjedhur e të emëruar të të gjitha niveleve, të cilët nuk duhet t'i mbështesin veprimet dhe vendimet e tyre në lidhje me zgjedhjet në çështje apo bindje politike.

B. KUADRI LIGJOR⁴²

2. Duke pasur parasysh parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, duhet rishikuar dispozitat e Kodit Zgjedhor që u jep kryetarëve të partive politike të drejta të veçanta kandidimi. Duhet siguruar që zgjedhësit të dinë paraprakisht kandidatët të cilët mund të zgjidhen si rezultat i mbështetjes së tyre.
3. Duhet të eliminohet përfshirja e partive politike në përzgjedhjen e gjyqtarëve që shqyrtojnë ankimimet zgjedhore.
4. Duhet të ndryshohen dispozitat në lidhje me përsëritjen e zgjedhjeve në një zonë zgjedhore, për të shprehur qartësisht dhe pa dykuptimshmëri kushtet e nevojshme për përsëritje zgjedhjesh.
5. Duhet menduar për përfshirjen e mekanizmave që mund t'i japin zgjedhësve si individë të drejtën e ankimit në rast të shkeljes së të drejtave të tyre zgjedhore.
6. Kodi Zgjedhor mund të ndryshohet në mënyrë që dispozitat për financim publik të fushatave zgjedhore të mos i japin avantazh disproporcional dhe të padrejtë partive parlamentare.

⁴² Këto rekomandime duhet të lexohen së bashku me rekomandimet e formuluar në rishikimet e mëparshme të këtij Kodi, duke përfshirë Opinione të Përbashkëta të Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës dhe OSBE/ODIHR-it për Kodin Zgjedhor në www.osce.org/documents/odihr/2009/03/36881_en.pdf.

7. Vëmendje duhet t'i kushtohet ndryshimit të dispozitave të Kodit Zgjedhor që kanë të bëjnë me financimin e fushatës, të cilat duhet të parashikojnë deklarimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të partive politike gjatë fushatës dhe për të specifikuar kriteret, sipas të cilave KQZ-ja mund të bëjë vetë verifikime të raporteve financiare të subjekteve zgjedhore.

C. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

8. Ndërkohë që duhet ruajtur transparencja dhe përfshirja e formimit dhe funksionimit të administratës së zgjedhjeve, Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohet me qëllim që të eliminohet çdo lloj mundësie për abuzim apo bllokim të procesit nga partitë politike. Në veçanti, duhet të ketë mekanizma të efektshme për të plotësuar vendet vakante në administratën zgjedhore, në rast se partitë nuk ushtrojnë të drejtën e tyre për të bërë emërim brenda afateve të caktuara. Kur duhet, këto mekanizma duhet të zbatohen menjëherë.
9. Me qëllim pavarësinë dhe profesionalizmin e administratës zgjedhore, partitë politike nuk duhet të lejohen që të zëvendësojnë në mënyrë arbitrare anëtarët e komisioneve të nivelit më të ulët. Zëvendësimi duhet të lejohet vetëm për arsye specifike të shprehura qartë në ligj.
10. Kur është e nevojshme, KQZ-ja duhet të përdorë më shumë autoritetin e saj të gjerë që i jep Kodi Zgjedhor, sidomos kundrejt komisioneve zgjedhore të nivelit më të ulët. Kur identifikon ose informohet për probleme në një KZAZ apo KQV të caktuar, KQZ-ja duhet të jetë më proaktive në hetimin dhe zgjidhjen e këtyre problemeve.
11. Duhet të intensifikohet dhe të përmirësohet trajnimi i anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe Grupeve të Numërimit.

D. REGJISTRIMI DHE IDENTIFIKIMI I ZGJEDHËSVE

12. Banka e të dhënave të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile duhet të pastrohet më tej dhe të përditësohet me qëllim që të përmirësohet cilësia e listave të zgjedhësve. Për këtë qëllim, rekomandohet që të forcohen dhe të ruhen kapacitetet e duhura administrative. Si shumica parlamentare, ashtu dhe opozita duhet të konsultohen në këtë proces, për të siguruar transparencë, për të trajtuar mangësitë që mbeten dhe për të parandaluar që regjistrimi civil dhe regjistrimi i zgjedhësve të bëhen përsëri një çështje politike dhe fushate.
13. Vëmendje duhet t'i kushtohet rregullimit të sistemit aktual të përpilimit të listave të zgjedhësve për grupe të veçanta zgjedhësish, në mënyrë që këta zgjedhës të mos përballen me rrezikun e privimit të votës për shkak të mungesës së efikasitetit apo keqfunksionimit të administratës së institucionit, ku ata do të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar.

E. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

14. Duhet hequr kufizimi që qytetarët të mund të nënshkruajnë vetëm në mbështetje vetëm të një partie apo kandidati. Qytetarët duhet të kenë mundësinë të nënshkruajnë për cilëndo parti ose person të cilit zgjedhin t'i mbështesin të drejtën për të marrë pjesë në zgjedhje.

15. Vëmendje mund t'i kushtohet heqjes së kërkesës që zgjedhësit të mund t'i depozitojnë nënshkrimet mbështetëse vetëm përpara një noteri apo në KQZ. Në vend të kësaj, personat që nënshkruajnë në mbështetje të një partie apo kandidati duhet t'i japin informacion të mjaftueshëm personal një përfaqësuesi të autorizuar të partisë ose kandidatit në mënyrë që të mund të identifikohen dhe kontaktohen, nëse lind nevoja për verifikim të mëtejshëm.

F. FUSHATA ZGJEDHORE

16. Autoritetet, ashtu si edhe partitë politike, duhet të marrin hapa vendimtare për të siguruar që mbi punonjësit e sektorit publik, aktivistët politikë apo qytetarët e tjerë të mos ushtrohet presion qoftë për të marrë pjesë në aktivitete të fushatës, qoftë për të mos u marrë me veprimtari politike, apo për të votuar në një mënyrë të caktuar. Çdo rast i një presioni të tillë duhet të hetohet me hollësi dhe fajtorët të sillen përpara drejtësisë në përputhje me ligjin.
17. Duhet të forcohen mekanizmat institucionale me qëllim që të monitorojnë keqpërdorimin e mundshëm të burimeve administrative për qëllime fushate, si dhe përdorimin e aktiviteteve zyrtare për fushatë, dhe që të vendosin përgjegjësit e këtyre akteve përpara përgjegjësisë.

G. MEDIA

18. Vëmendje mund t'i kushtohet mekanizmave që minimizojnë politizimin e punës së Bordit të Monitorimit të Medias (BMM) siç është krijimi i një formule tjetër për caktimin e anëtarëve të këtij Bordi. Në BMM mund të përfshihen ekspertë në fushën e analizimit të medias ose ekspertë të caktuar nga institucione të pavarura të medias dhe jo nga anëtarë të veçantë të KQZ-së.
19. Vëmendje mund t'i kushtohet trajnimit të anëtarëve të BMM-së dhe monitoruesve të medias në analizimin e përmbajtjes cilësore dhe sasiore, për të bërë të mundur që BMM-ja të vlerësojë nëse operatorët përmbushin detyrimet e tyre të detajuara, të cilat janë përcaktuar në Kodin Zgjedhor.
20. Vëmendje mund t'i kushtohet përfshirjes së mbulimit të të gjitha veprimtarive të qeverisë gjatë një fushate zgjedhore në kohën që i është caktuar partisë së cilës i përket kreu i institucionit që organizon veprimtarinë, me qëllim që të shmangen interpretime kundërshtuese për atë nëse një veprimtari qeveritare ka apo nuk ka lidhje me fushatën. Më e pakta, neni 84.2 b i Kodit Zgjedhor duhet të ndryshohet për të dhënë një përkufizim të qartë në lidhje me "veprimtaritë qeveritare, që lidhen me fushatën zgjedhore".

H. VOTIMI, NUMËRIMI, PËRMBLEDHJA DHE SHPALLJA E REZULTATEVE

21. Duhet të garantohet respektimi më i mirë i procedurave të votimit nga KQV-të, sidomos atyre në lidhje me fshehtësinë e votës dhe përdorimin e bojës për të shënuar gishtërinjtë e zgjedhësve, nëpërmjet trajnimit të duhur të kryetarëve, përgjegjësia e të cilëve është të sigurojnë respektimin e dispozitave ligjore.
22. Duhet të zbatohen rreptësisht rregullat në lidhje me praninë e individëve në qendrat e votimit dhe në VNV. Në veçanti, duhet të garantohet që në VNV të jenë të pranishëm vetëm personat e autorizuar. Siç parashikohet në ligj, numri i vëzhguesve të partive duhet të kufizohet vetëm në ata persona që mbajnë akreditimin e përcaktuar. Duhet të parandalohen në mënyrë efikase ndërhyrjet nga individë të paautorizuar.

23. Vëmendje mund t'i kushtohet ndryshimit të procedurave të numërimit dhe mbledhjes së rezultateve, në mënyrë që të plotësohen afatet përkatëse të parashikuara nga Kodi Zgjedhor. Megjithatë, kjo nuk duhet të bëhet në dëm të transparencës së procesit të numërimit.
24. Kandidatët që konkurrojnë duhet të lejohen të vëzhgojnë numërimin në mënyrë të barabartë. Duhet të bëjnë përpjekje të mëtijshme për të përmirësuar mundësinë që vëzhguesit të kontrollojnë saktësinë e numërimit. Sistemi aktual duhet të zbatohet në mënyrë të tillë, që vëzhguesit të mund të shohin se në cilin grumbull vihet secila fletë votimi.
25. Nëse ruhet sistemi aktual i monitorimit me kamera për vlerësimin e fletëve të votimit, vëmendje mund t'i kushtohet rregullimit të tij në mënyrë që të jetë më e lehtë për vëzhguesit të shohin se për kë është hedhur çdo fletë votimi. Atyre që kanë të drejtë të marrin kopje të regjistrimit të numërimit duhet t'u jepen këto kopje menjëherë në bazë të kërkesës së tyre.
26. Kodi Zgjedhor duhet të specifikojë qartë se si Grupet e Numërimit dhe KZAZ-të duhet t'i trajtojnë kutitë e votimit dhe kutitë me material zgjedhor që janë konsideruar të rregullta kur janë marrë në dorëzim nga KZAZ-ja, por që më vonë kanë rezultuar me probleme që tregojnë shkelje apo parregullsi të rënda. Kodi Zgjedhor duhet të shprehë qartë, në mënyrë të plotë, se cilat kushte duhet të plotësohen që një kuti votimi të mos përfshihet në numërim, edhe pse, kur është pranuar, është klasifikuar si e rregullt. Të gjitha këto raste duhet t'i raportohen menjëherë KQZ-së. Vëmendje mund t'i kushtohet shqyrtimit të mëtijshëm të këtij kontingjenti të kutive të votimit me një vendim të KQZ-së.
27. Vëmendje i duhet kushtuar faktit që përpara se KQZ-ja të mbledhë rezultatet nga zonat zgjedhore, ky Komision të zhvillojë hetimet e veta administrative në lidhje me votimin dhe numërimin e votave bazuar në konstatimet e KQV-ve, KZAZ-ve dhe grupeve të numërimit. Duhet të rishikohet Neni 123 i Kodit Zgjedhor në mënyrë që votat që numërohen pas një hetimi administrativ të KQZ-së të përfshihen në Tabela Përmbledhëse të Rezultateve.
28. Kur publikon rezultatet paraprake, KQZ-ja duhet të përfshijë numrin e zgjedhësve të regjistruar, zgjedhësit që u paraqitën për votim dhe fletët e pavlefshme të votimit, deri në nivelin e qendrës së votimit.

I. ANKESAT DHE KËRKESËPADITË

29. Shpallja e pavlefshme e rezultateve nga një ose më shumë se një qendra votimi nuk duhet të lidhet vetëm me ndikimin që mund të ketë kjo në ndarjen e mandateve. Shkelje të rënda të mundshme të ligjit ose arsye të tjera që tregojnë se rezultati është cenuar rëndë, duhet të jenë arsye të mjaftueshme për të shpallur të pavlefshme zgjedhjet në qendra votimi dhe për të lejuar një rinumërim të mundshëm.

J. PJESËMARRJA E GRAVE

30. Duhet të rishikohen dispozitat e Kodit Zgjedhor që përcaktojnë kuota gjinore për listat e kandidatëve, jo vetëm në mënyrë që të plotësohet standardi prej 30% i kërkuar në Ligjin për Barazinë Gjinore në Shoqëri, por edhe për të mbyllur hapësirat që i lejojnë partitë t'i shmangen qëllimit të vetë ligjit. Dispozitat përkatëse duhet të rishikohen për të

përcaktuar qartë mënyrën se si duhet të arrihet ekuilibri gjinor, si në numrat përfaqësues të çdo gjinie në listë, ashtu edhe në lidhje me ekuilibrimin e tyre në renditje në listë.

K. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE

31. Fushatat e KQZ-së për informimin e zgjedhësve duhet të shtrihen në të gjitha komunitetet e minoriteteve në mënyrë të fokusuar.

SHTOJCË: REZULTATET E ZGJEDHJEVE

Numri i përgjithshëm i zgjedhësve në listat e zgjedhësve	3,084,946
Numri i zgjedhësve që votuan	1,566,079
Përqindja e zgjedhësve që votuan	50.77%
Numri i fletëve të vlefshme të votimit	1,519,176
Numri i fletëve të votimit të pavlefshme	46,903
Përqindja e fletëve të votimit të pavlefshme	2.99%

Nr.	Subjekti Zgjedhor	Votat	Përqindja	Mandatet	
Koalicioni "Aleanca e Ndryshimit"					
1	Partia Aleanca Demokratike	DA	4,682	0.31	0
2	Bashkimi Liberal-Demokrat	LDU	5,008	0.33	0
3	Partia Demokristiane Shqiptare	DCL	6,095	0.40	0
4	Partia Agrare Ambientaliste	EAP	13,296	0.88	0
5	Aleanca Maqedonase për Integrim Evropian	MAEI	1,043	0.07	0
6	Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	ADS	1,067	0.07	0
7	Partia Balli Kombëtar	NFP	5,112	0.34	0
8	Partia Balli Kombëtar Demokrat	NDFP	4,177	0.27	0
9	Partia Evropiane Demokracia e Re	NEDPA	2,111	0.14	0
10	Partia Demokratike	DP	610,463	40.18	68
11	Partia e të Drejtave të Mohuara e Re	NDRP	1,408	0.09	0
12	Partia Forca Albania	FAP	319	0.02	0
13	Partia Lëvizja e Legalitetit	LMP	10,711	0.71	0
14	Partia Ora Shqiptare	ATP	786	0.05	0
15	Partia për Drejtësi dhe Integrim	PJI	14,477	0.95	1
16	Partia Republikane	RP	31,990	2.11	1
	Shuma		712,745	46.92	70
Koalicioni "Poli i Lirisë"					
17	Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	NDM	10,753	0.71	0
18	Partia Bashkimi Demokrat	DUP	1,030	0.07	0
19	Partia Demokristiane	DCP	13,308	0.88	0
20	Partia e Reformave Demokratike Shqiptare	ADRP	495	0.03	0
21	Partia Konservatore Shqiptare	CONS.P	1,067	0.07	0
22	Partia Rrugë e Lirisë	FRP	1,002	0.07	0
	Shuma		27,655	1.82	0
Koalicioni "Aleanca Socialiste për Integrim"					
23	Lëvizja për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut	HRFM	2,931	0.19	0
24	Lëvizja Socialiste për Integrim	SMI	73,678	4.85	4
25	Partia e Gjëlber	GP	437	0.03	0
26	Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve	PPER	376	0.02	0
27	Partia e Vërtetë Socialiste '91	RSP 91	6,548	0.43	0
28	Partia Toleranca e Re	NTP	437	0.03	0
	Shuma		84,407	5.56	4
Koalicioni "Bashkimi për Ndryshim"					
29	Partia e Bashkimit për Drejtave të Njeriut	HRUP	18,078	1.19	1
30	Partia Demokracia Sociale	SDY	10,395	0.68	0
31	Partia G99	G 99	12,989	0.86	0
32	Partia Social-Demokrate	SDP	26,700	1.76	0
33	Partia Socialiste	SP	620,586	40.85	65
	Shuma		688,748	45.34	66
34	Abdullah Adil Omuri (kandidat i propozuar nga një grup votuesish – vetëm në zonën e Tiranës)		756	0.05	0
35	Partia Ligj dhe Drejtësi	LaJuP	4,865	0.32	0
	TOTALI		1,519,176	100.00	140

RRETH OSBE/ODIHR-it

Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së që ndihmon shtetet pjesëmarrëse “të sigurojnë respektim të plotë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të respektojnë shtetin e së drejtës, të promovojnë parimet e demokracisë dhe (...) të ndërtojnë, të forcojnë dhe të mbrojnë institucionet demokratike, si dhe të promovojnë tolerancën në të gjitha nivelet e shoqërisë” (Dokumenti i Helsinkit 1992). Kjo pjesë është edhe dimensionin human i OSBE-së.

OSBE/ODIHR-i, me seli në Varshavë (Poloni), u krijua në Samitin e Parisit në vitin 1990 si Zyra për Zgjedhje të Lira dhe filloi funksionimin në maj 1991. Një vit më vonë, emri i Zyrës u ndryshua për të pasqyruar një mandat më të gjerë, në të cilin të përfshiheshin të drejtat e njeriut dhe demokratizimi. Sot, për këtë organizatë të punojnë mbi 100 vetë.

OSBE/ODIHR-i është organizmi kryesor në Evropë në fushën e **vëzhgimit të zgjedhjeve**. Ai bashkërendon dhe organizon dërgimin e mijëra vëzhguesve çdo vit për të vlerësuar nëse zgjedhjet në zonën e OSBE-së janë zhvilluar në përputhje me angazhimet ndaj OSBE-së, standarde të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, dhe me legjislacionin vendas. Metodologjia e vet unike siguron një vështrim në thellësi të të gjithë elementëve të një procesi zgjedhor. Me anë të projekteve të asistencës, OSBE/ODIHR-i ndihmon shtetet pjesëmarrëse të përmirësojnë kuadrin e tyre zgjedhor.

Veprimtaritë e Zyrës për **demokratizim** përfshijnë fushat e mëposhtme tematike: shtetin e së drejtës, mbështetjen legjislative, qeverisjen demokratike, migrimin dhe lirinë e lëvizjes, si edhe barazinë gjinore. OSBE/ODIHR-i zbaton një numër programesh asistence çdo vit, duke kërkuar të zhvillojë strukturat demokratike.

Po ashtu, OSBE/ODIHR-i monitoron shtetet pjesëmarrëse në përmbushjen e detyrimeve të tyre për të promovuar dhe për të mbrojtur të **drejtat e njeriut** dhe liritë themelore në përputhje me angazhimet e OSBE-së për dimensionin njerëzor. Kjo arrihet duke punuar me një sërë partnerësh me qëllim nxitjen e bashkëpunimit, ngritjen e kapaciteteve dhe shkëmbimin e ekspertizës në fusha si të drejtat e njeriut në luftën kundër terrorizmit, përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut për personat e trafikuar, edukim dhe trajnim për të drejtat e njeriut, monitorimi i të drejtave të njeriut dhe raportimi mbi to, si edhe të drejtat e njeriu të grave dhe siguria.

Për fushën e **tolerancës** dhe **mosdiskriminimit**, OSBE/ODIHR-i i jep mbështetje shteteve pjesëmarrëse për të forcuar përgjigjet e tyre ndaj krimeve të urrejtjes dhe incidenteve të racizmit, ksenofobisë, anti-Semitizmit dhe formave të tjera të intolerancës. Veprimtaritë e OSBE/ODIHR-it në këto fusha përqendrohen në tematikat e mëposhtme: legjislacioni, trajnimi për zbatimin e ligjit, monitorimi i përgjigjes që u jepet krimeve dhe incidenteve të motivuara nga urrejtja, si edhe raportimi mbi to dhe vëzhgimi i mëtejshëm i tyre, por edhe aktivitete edukative për të promovuar tolerancën, respektin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë.

OSBE/ODIHR-i këshillon shtetet pjesëmarrëse mbi politikën e tyre për komunitetet **rome dhe sinti**. Zyra nxit rritjen e kapaciteteve dhe lidhjet mes komuniteteve rome dhe sinti, si dhe inkurajon pjesëmarrjen e përfaqësuesve romë dhe sinti në organet politikëbërëse.

Të gjitha veprimtaritë e ODIHR-it zhvillohen në bashkëpunim dhe bashkërendim të ngushtë me shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, institucionet dhe veprimet në terren të OSBE-së, si dhe me organizma të tjerë ndërkombëtarë.

Informacione të mëtejshme mund të gjeni në faqen e internetit të ODIHR-it në www.osce.org/odihr.